RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Mbi

Auditimin Financiar

Tiranë, shtator 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3 – 9**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
II.	**HYRJA**	**9 – 12**
1.	Objektivat dhe qëllimi	
2.	Identifikimi i çështjes.....	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
5.	Kriteret e vlerësimit.....	
5.	Standardet e auditimit.....	
7.	Metodat e auditimit.....	
8.	Dokumentimi i auditimit.....	
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**12 – 55**
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	12 – 13
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	**13 – 55**
2.1	*Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.*	*13 – 17*
2.1.2	*Auditim mbi veprimtarinë e Auditit të Brendshëm*	*17 – 19*
2.2	*Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.*	*19 – 29*
2.2.5	*Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi tyre*	*29 – 36*
2.3	*Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2025.*	*36 – 55*
IV.	**REKOMANDIME**	**55 – 67**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar me objekt vlerësimin e veprimtarisë së aktivitetin ekonomik dhe financiar në Bashkinë Librazhd. Auditimi mbuloi periudhën e vitit ushtrimor nga data 01.01.2025 deri në datën 31.12.2025. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Librazhd si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, veprimtarinë e auditit të brendshëm, dhe auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, etj.

Bashkia Librazhd është njësi e vetëqeverisjes vendore, e organizuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , i ndryshuar dhe Ligji nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë. Bashkia ushtron funksionet dhe kompetencat e përcaktuara me ligj në territorin e saj administrativ, nëpërmjet organeve të zgjedhura, Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, si dhe strukturave administrative në varësi të saj.

Bashkia Librazhd kufizohet në veri me Bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jug me Bashkinë Përrenjas dhe në perëndim me Bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit. Sipas Censusit të vitit 2023, Librazhdi ka një popullsi prej 23,312 banorësh. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 793.36 km^2. Densiteti i popullsisë është 55.68 banorë/km^2.

Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, si: Librazhdi, Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stërblevë, Polis dhe Orenjë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit, e cila ka nën administrimin një qytet dhe 52 fshatra

Bashkia Librazhd administron një sërë funksionesh e shërbimesh publike vendore, si dhe pronën dhe burimet financiare publike në administrim. Për realizimin e funksioneve të saj, Bashkia financohet nga transfertat nga buxheti i shtetit, të ardhurat e veta nga taksat, tarifat dhe burime të tjera, si dhe financime të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, Bashkia harton dhe zbaton buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm, administron të ardhurat dhe shpenzimet publike, realizon investime dhe menaxhon pasurinë publike vendore. Për periudhën objekt auditimi, veprimtaria financiare dhe buxhetore e Bashkisë është administruar nëpërmjet strukturave përgjegjëse për financat, buxhetin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Auditimi është fokusuar në vlerësimin e mënyrës së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, administrimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe në përdorimin e burimeve financiare publike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe parimet e menaxhimit të mirë financiar.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore", i ndryshuar, nenit 50 pikat 1 dhe 2. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Librazhd si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar

nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit dhe objektivat.

Qëllimi i auditimit financiar është të vlerësojë nëse pasqyrat dhe informacioni financiar i raportuar nga subjekti i audituar paraqesin në mënyrë të drejtë, të plotë dhe të besueshme gjendjen dhe rezultatet financiare të tij, si dhe nëse administrimi dhe përdorimi i burimeve financiare është kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullat e raportimit financiar.

Auditimi është kryer për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, me fokus të veçantë në të ardhurat, shpenzimet, zbatimin e buxhetit dhe informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Objektivat e auditimit. Në funksion të qëllimit të auditimit dhe bazuar në drejtimet e përcaktuara në programin e auditimit, objektivat kryesore për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025 kanë qenë**:**

- *Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe funksionimit të auditimit të brendshëm*, për të përcaktuar efektivitetin e masave dhe procedurave të vendosura për administrimin dhe kontrollin e burimeve publike;
- *Vlerësimi i procesit të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit*, si dhe i administrimit dhe realizimit të të ardhurave të Bashkisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe buxhetor në fuqi;
- *Vlerësimi i saktësisë, plotësisë dhe besueshmërisë së raportimit financiar*, përfshirë pasqyrat financiare të vitit 2025, duke vlerësuar nëse transaksionet dhe informacioni financiar janë regjistruar dhe raportuar në përputhje me kërkesat e raportimit financiar.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është me zgjedhje, mikse, sasiore dhe cilësore.

Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 60% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 36,600 mijë lekë për vitin 2025, Gabimi i lejuar (10%) në vlerën 3,660 mijë lekë.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: *Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm*.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- *Verifikimi i transaksioneve;*
- *Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;*
- *Intervistat;*
- *Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.*

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të disa të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Për këtë grupi i auditimit ka konstatuar **18** gjetje dhe ka dhënë **21** rekomandime, *nga të cilat;* masa organizative 14 gjetje me 15 rekomandime, masa për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve

publike (të ardhurat e munguara) 4 gjetje dhe 6 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli. Nga auditimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) rezultoi se Bashkia Librazhd nuk i ka zbatuar në mënyrë të plotë kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor për menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm, planifikimin institucional dhe administrimin e burimeve. U konstatua se vetëm Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm ishin hartuar planet vjetore/mujore të punës dhe raportet e analizës së veprimtarisë, ndërsa strukturat e tjera nuk i kanë përmbushur këto kërkesa. Gjithashtu, në fushën e burimeve njerëzore u evidentuan mungesa në dokumentacionin e dosjeve të personelit dhe mungesë e planifikimit dhe zhvillimit të trajnimeve të brendshme gjatë vitit 2025**.**

Në aspektin financiar, kontabiliteti mbahet në programin Excel, pa një sistem të dedikuar kontabël. Gjithashtu, nuk ishte hartuar dhe miratuar gjurma e auditimit, nuk është hartuar Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional dhe mungon një sistem i integruar i teknologjisë së informacionit, i shoqëruar me politika dhe procedura të miratuara për sigurinë e informacionit.

*Auditimi i brendshëm***.** Auditimi i funksionimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm u konstatuan mangësi në organizimin dhe ushtrimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Konkretisht, nuk ishte ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm dhe asnjë nga punonjësit e Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk disponontе certifikatën profesionale "Auditues i Brendshëm".

Gjithashtu, Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të Auditimit u mungonin disa fusha me risk të lartë, ndër të cilat Burimet Njerëzore, Shërbimet Mbështetëse, Prokurimet Publike, si dhe Planifikimi, Zhvillimi dhe Kontrolli i Territorit. Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ishte hartuar dhe zbatuar Programin e Sigurimit dhe Përmirësimit të Cilësisë, duke mos garantuar kështu monitorimin dhe vlerësimin sistematik të cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarisë së auditimit.

Këto mangësi dobësojnë funksionimin e auditimit të brendshëm dhe kufizojnë aftësinë e tij për t'i ofruar drejtimit siguri dhe këshillim të pavarur e efektiv mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes së institucionit.

***Hartimi dhe zbatimi i buxhetit*.** Nga auditimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027 dhe i zbatimit të buxhetit të vitit 2025 rezultoi se planifikimi buxhetor, veçanërisht ai i investimeve, nuk ishte mbështetur në një vlerësim të mjaftueshëm të kapacitetit real financiar të Bashkisë dhe të performancës historike në realizimin e të ardhurave.

Për vitin 2025, nga fondi i përgjithshëm i planifikuar në vlerën 1,776,797 mijë lekë, u realizuan 1,570,315 mijë lekë, ose 88%, duke rezultuar me një mosrealizim prej 206,482 mijë lekësh. Në zërin e investimeve, nga 537,496 mijë lekë të planifikuara, u realizuan 427,388 mijë lekë, ose 80%, me një mosrealizim prej 110,108 mijë lekësh.

Në aspektin ekonomik, planifikimi i investimeve rezultoi i mbështetur kryesisht në nivelin e të ardhurave të programuara dhe jo në kapacitetin real të arkëtimit të tyre. Kjo qasje nuk ka marrë në konsideratë sa duhet faktin se realizimi historik i të ardhurave vendore ka qenë në nivele rreth 70–80% të planit. Për rrjedhojë, niveli i angazhimeve për investime ka qenë më i lartë se kapaciteti financiar faktik i Bashkisë për të siguruar likuiditetin e nevojshëm për financimin dhe likuidimin e tyre në afatet e parashikuara.

Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e investimeve është planifikuar të financohet dhe likuidohet përgjatë një periudhe 2–3-vjeçare, ndonëse kontratat përkatëse parashikonin afate zbatimi brenda një viti buxhetor. Kjo mënyrë planifikimi, në mungesë të analizave të mjaftueshme financiare dhe tekniko-ekonomike mbi burimet reale të financimit dhe profilin e

pagesave, ka ndikuar në shtyrjen e likuidimit të detyrimeve, në akumulimin e detyrimeve të papaguara dhe në kufizimin e hapësirës fiskale të Bashkisë për periudhat e ardhshme.

Në zbatimin e buxhetit, mosrealizimi i të ardhurave vendore ka sjellë kufizim të burimeve të disponueshme për përmbushjen në kohë të detyrimeve financiare. Konkretisht, tre fatura me vlerë të mbetur 12,949 mijë lekë, ishin likuiduar vetëm pjesërisht.

Në tërësi, këto konstatime tregojnë se planifikimi buxhetor dhe veçanërisht ai i investimeve nuk ka qenë i harmonizuar në mënyrë të mjaftueshme me kapacitetin real të gjenerimit të të ardhurave dhe me aftësinë paguese të Bashkisë. Kjo ka krijuar një mospërputhje ndërmjet nivelit të angazhimeve buxhetore dhe burimeve faktikisht të disponueshme, duke ndikuar në realizimin e investimeve, në menaxhimin e likuiditetit dhe në rritjen e presionit mbi buxhetet e viteve pasardhëse.

Administrimi i të ardhurave. Auditimi i administrimit të të ardhurave vendore evidentoi një nivel të pamjaftueshëm të realizimit të planit. Për vitin 2025, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore u realizuan në masën 76%, ku nga 214,268 mijë lekë të planifikuara u arkëtuan 163,800 mijë lekë, duke mbetur të parealizuara 50,468 mijë lekë. Sipas kategorive, taksat vendore u realizuan në masën 68%, tarifat vendore 92%, të ardhurat nga sektori i pyjeve dhe kullotave 72% dhe të ardhurat e tjera 67%. Auditimi evidentoi se rritja e planit të të ardhurave me 38,762 mijë lekë krahasuar me vitin 2024 nuk ishte mbështetur në një analizë të plotë të bazës tatimore, kapaciteteve reale të arkëtimit, historikut të realizimit dhe rezervave të mundshme të të ardhurave vitin 2024 nuk ishte mbështetur në një analizë të plotë të bazës tatimore, kapaciteteve reale të arkëtimit, historikut të realizimit dhe rezervave të mundshme të të ardhurave.
Një rast domethënës është Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë, ku plani u rrit nga 10,302 mijë lekë në vitin 2024 në 20,000 mijë lekë në vitin 2025, ndërsa realizimi faktik ishte vetëm 28% e planit. Mosrealizimi i të ardhurave ka krijuar mungesë të burimeve financiare për financimin e shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara.

Një problem tjetër i rëndësishëm lidhet me administrimin e të ardhurave nëpërmjet agjentëve tatimorë. Bashkia nuk disponon një bazë të plotë, të saktë dhe të përditësuar të subjekteve tatimpaguese dhe detyrimeve përkatëse, ndërsa rakordimet me agjentët tatimorë nuk kryhen në mënyrë të plotë dhe efektive. Kjo ka kufizuar verifikimin e saktësisë së të ardhurave të arkëtuara dhe të transferuara në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu, në fund të vitit 2025 gjendja e debitorëve ishte 110,873,273 lekë për 5,287 subjekte, ndërsa 22,932,391 lekë përfaqësonin debitorë të krijuar gjatë vitit 2025 dhe, rrjedhimisht, të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. U evidentuan gjithashtu detyrime të paarkëtuara nga TNI për ndërtimet informale, në vlerën 8,933,000 lekë për 200 praktika, si dhe detyrime të pambledhura nga kontratat e qirasë në vlerën 4,350,965 lekë në fund të vitit.

Pasqyrat financiare 2025 dhe administrimi i aktiveve. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2025 u konstatuan mangësi në administrimin kontabël dhe fizik të aktiveve afatgjata materiale (AQT), të lidhura me inventarizimin, evidentimin, vlerësimin, amortizimin, sistemimin dhe raportimin e tyre. Këto mangësi kanë ndikuar në saktësinë dhe plotësinë e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare.

Procesi i inventarizimit fizik nuk ishte shtrirë në të gjitha kategoritë e aktiveve afatgjata materiale. Për rrjedhojë, për një pjesë të aktiveve pasqyrat financiare pasqyronin kryesisht vlera kontabël, pa u mbështetur në evidenca të plota dhe të përditësuara mbi ekzistencën, gjendjen dhe vlerën e tyre fizike. Gjithashtu, nuk ishte krijuar regjistri i aktiveve në përputhje me kërkesat

përkatëse, ndërsa Komisioni i Inventarizimit nuk kishte hartuar relacionin përmbledhës mbi rezultatet e procesit të inventarizimit.

Në llogarinë 202 "Studime dhe projektime", nga 46,341,008 lekë të regjistruara për 46 objekte, 34 projekte me vlerë 32,361,069 lekë i përkisnin periudhës 2011–2023. Për këto projekte nuk kishte informacion të dokumentuar dhe të mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ato ishin përdorur në realizimin e investimeve, nëse ishin ende në fuqi apo nëse duhej të sistemoheshin në llogaritë përkatëse të investimeve të përfunduara. Kjo situatë krijon pasiguri mbi klasifikimin dhe vlerën reale të aktiveve, si dhe ndikon në përcaktimin e saktë të amortizimit.

Në llogarinë 212 "Ndërtime konstruksione" u konstatua se për 36 objekte, me vlerë të mbetur 270,428,882 lekë, nuk ishte pasqyruar në mënyrë të saktë ndikimi financiar i investimeve shtesë, rikonstruksioneve, shpenzimeve të mbikëqyrjes dhe kolaudimit. Gjithashtu, amortizimi nuk ishte llogaritur në mënyrë individuale për çdo aktiv, por në mënyrë të grupuar, duke ndikuar në përcaktimin e saktë të vlerës neto kontabël të aktiveve. Auditimi evidentoi gjithashtu mungesë të procedurave të dokumentuara për rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale. Kjo ka ndikuar në paraqitjen e vlerës së tyre në pasqyrën e pozicionit financiar dhe ka sjellë rrezik për nënvlerësimin e disa aktiveve. Ndërkohë, në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", nuk ishte sistemuar dhe zbritur nga vlera kontabël shuma prej 78,700,102 lekësh, që i përkiste 8 aktiveve të cilat duhej të transferoheshin te UK Elbasan.

Mospërputhje u konstatuan edhe ndërmjet vlerave të çeljes të paraqitura në Aneksin 7/a dhe analizës së çeljes së inventarit kontabël për disa llogari. Këto diferenca kanë ndikuar në saktësinë e pasqyrimit të shtesave, pakësimeve dhe vlerave përfundimtare të aktiveve për vitin 2025.

Një tjetër mangësi me ndikim të drejtpërdrejtë në pasqyrat financiare u konstatua në llogarinë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT", e cila ishte raportuar me vlerë zero. Nga testimi i kontratave dhe dokumentacionit mbështetës rezultoi se në këtë llogari duhej të ishte pasqyruar një vlerë prej 70,551,606 lekësh. Për rrjedhojë, aktivet dhe shpenzimet në proces rezultojnë të nënvlerësuara me këtë shumë.

Në tërësi, mangësitë e konstatuara tregojnë se procesi i administrimit dhe raportimit kontabël të aktiveve afatgjata materiale nuk garanton në nivelin e nevojshëm që vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare të jenë të plota, të sakta, të klasifikuara dhe të mbështetura me dokumentacionin përkatës. Kjo krijon risk për mbivlerësim ose nënvlerësim të aktiveve, amortizimit dhe investimeve në proces, si dhe ndikon në besueshmërinë e informacionit financiar të raportuar nga Bashkia.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Forcimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e nëpunësit autorizues, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke siguruar hartimin dhe zbatimin e planeve vjetore dhe periodike të punës, raportimin e veprimtarisë nga strukturat e administratës, zhvillimin e trajnimeve të stafit, plotësimin e dokumentacionit të personelit, ngritjen e një sistemi të dedikuar financiar-kontabël, hartimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore, miratimin e Planit Strategjik të Zhvillimit dhe forcimin e sigurisë së informacionit.

Përmirësimi i funksionimit të auditimit të brendshëm: Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe drejtimi i institucionit të marrin masa për funksionalizimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, pajisjen e stafit me certifikimin profesional "Auditues i Brendshëm", përditësimin e planit vjetor të auditimit mbi bazën e analizës së riskut dhe hartimin e Programit të Sigurimit të Cilësisë, me qëllim rritjen e efektivitetit, pavarësisë dhe cilësisë së veprimtarisë audituese.

Përmirësimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave vendore: Drejtoria e Tatim-Taksave, në bashkëpunim me strukturat financiare, të hartojë plane realiste për realizimin e të ardhurave nga

taksat dhe tarifat vendore, bazuar në analiza të hollësishme për çdo burim të ardhurash, realizimin e viteve paraardhëse dhe mundësinë reale të arkëtimit të detyrimeve të prapambetura. Të merren masa për identifikimin, monitorimin dhe arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 110,873,273 lekë, duke përmirësuar procesin e administrimit dhe mbledhjes së të ardhurave vendore.

Përmirësimi i planifikimit buxhetor dhe administrimit të fondeve publike: Gjatë hartimit të buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm, Bashkia Librazhd të bazohet në parashikime reale të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke analizuar mosrealizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, veçanërisht për investimet dhe shpenzimet operative. Planifikimi i investimeve publike të kryhet vetëm mbi bazën e burimeve të sigurta financimi, ndërsa në rast mosrealizimi të të ardhurave të kryhen korrigjimet përkatëse të planit të shpenzimeve brenda afateve ligjore.

Menaxhimi i detyrimeve financiare dhe vendimeve gjyqësore: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve për shlyerjen e faturave të papaguara dhe detyrimeve të krijuara nga vendimet gjyqësore në vlerën 5,298,138 lekë, duke garantuar evidentimin dhe raportimin e saktë të tyre në Ministrinë e Financave dhe pasqyrat financiare të institucionit.

Drejtoria Ekonomike të sigurojë planifikimin e fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe raportimin e tyre si shpenzime në Ministrinë e Financave.

Saktësimi i administrimit dhe kontabilizimit të aktiveve afatgjata material: Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit të marrë masa për kryerjen e inventarizimit fizik dhe kontabël të aktiveve afatgjata materiale, përfshirë llogaritë: 210 "Toka, troje, terrene"**;** 211 "Pyje, plantacione"**;** 212 "Ndërtesa dhe konstruksione"**;** 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"**.** Për diferencat e konstatuara nga inventarizimi dhe aktivet jashtë përdorimit të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të kryhen sistemimet kontabël sipas legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu, të kryhen sistemimet kontabël për pasqyrimin në llogarinë *231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* të vlerës prej *70,551,606 lekë***,** që i përket investimeve të papërfunduara në llogaritë *212 "Ndërtesa dhe konstruksione"* dhe *213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"***.**

Rivlerësimi dhe sistemimi i pasurisë së institucionit: Kryetari i Bashkisë të ngrejë grupet e punës për:

- rivlerësimin e aktiveve të klasifikuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" dhe 215 "Mjete transporti" dhe reflektimin e ndryshimeve në kontabilitet;
- transferimin në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" sh.a. të 8 artikujve kontabël pjesë e inventarit, duke kryer veprimet përkatëse kontabël dhe duke zbritur nga pasqyrat financiare vlerën 78,700,102 lekë.

Rritja e arkëtimit të detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga "Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale", për objektet e legalizuara në vlerën 8,933 mijë lekë.

Arkëtimi i detyrimeve nga qiratë e fondit pyjor dhe kullosor: Drejtoria Juridike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave dhe Drejtorinë Ekonomike, të ndjekë procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga 18 subjekte qiramarrëse, në vlerën 4,350,965 lekë.

I.1. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Librazhd, grupi i auditimit të KLSH-së ka dhënë *"Opinion të kualifikuar"* për pasqyrat financiare. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative dhe rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe rekomandime për arkëtimin e të ardhurave të munguara, uljen e borxhit tatimor.

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Librazhd për periudhën ushtrimore të vitit 2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Librazhd nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinion", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një ***opinioni të kualifikuar****, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinionin e kualifikuar[1]**:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Librazhd, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (SNA-700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura. Materialiteti i llogaritur bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin 2025 është 36,600 mijë lekë dhe gabimi i lejuar (10%) në vlerën 3,660 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë parregullsitë si më poshtë:

- Llogaria 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*", nuk është pakësuar për vlerën e 8 artikujve për ujësjellës e kanalizime në shumën 78,700,102 lekë të transferuara Ujësjellës Kanalizime Elbasan.
- Llogaria 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", në mbyllje të vitit 2025, paraqitet me vlerën 0 lekë, ndërkohë që nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se për 3 kontrata, me vlerë totale 185,624,714 lekë, punimet nuk kishin përfunduar dhe deri në fund të vitit ishin likuiduar 45,093,279 lekë, vlerë e cila duhej të ishte evidentuar në llogarinë 231.
- Llogaria 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*", për 7 objekte me vlerë kontrate 154,715,584 lekë të cilat janë likuiduar në fakt në vlerën 25,458,327 lekë, pra vlera e llogarie 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", është raportuar e nënvlerësuar për vlerën 70,551,606 lekë,
- Llogaria 202 "*Studime dhe projektime*", ka rezultuar se për vlerën 32,361,069 lekë, nuk ka informacion nëse janë vënë në zbatim ose jo pavarësisht faktit që disa nga këto studime e kërkime i përkasin investimeve për objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" , i ndryshuar, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 552/1 Prot., datë 22.05.2026 me objekt: "*Auditim financiar*", miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Librazhd nga data 26.05.2026 deri në datën 19.06.2026, u krye auditimi për periudhën

[1] SNA-705- Audituesi duhet të shpreh një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku janë materiale por jo të përhapura.

e vitit ushtrimor nga data 01.01.2025 deri në datën 31.12.2025 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. K.GJ, *përgjegjës grupi;*
2. A.B, *auditues;*
3. M.M, *auditues*.

1. OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

- Objektivat dhe Qëllimi i auditimit. Objektivi i *auditimit financiar* është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

- Identifikimi i çështjes. Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Librazhd, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i adituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Librazhd.

- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Strukturat drejtuese të Bashkisë Librazhd, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, etj.

- Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (*audituesit e KLSH-së*), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet me opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- *Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;*
- *Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;*
- *Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit, etj.;*
- *Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;*
- *Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).*
- *Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;*

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Librazhd, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

- **Kriteret e vlerësimit.** Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:
-Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "*Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; - Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar; - Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*"; -Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; -Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; - Ligji nr. 152-2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; -Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar; -Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "*Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.
- VKM nr. 500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendor"; -VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim; -VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime; -VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; -Udhëzimin nr. 15 datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike"; - Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar; - Udhëzimi i MF nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"; - Udhëzim i MF nr. 2, datë 27.09.2019 "Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore"; - Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", i ndryshuar; - Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2021 "Për

mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit"; - Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar;
-Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut, etj.

- Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. INTOSAI P1- Deklarata e Limës me udhëzuesit për kryerjen e auditimit; ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"; ISSAI 1300 "Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare"; ISSAI 200 "Parimet e auditimit financiar" dhe ISSAI 2000-2200 "Aplikimi i standardeve te auditimit financiar"; ISSAI 1000-2999 "Udhëzues të Auditimit Financiar";
- INTOSAI GOV 9100 "Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik" si dhe INTOSAI GOV 9110 "Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilisteve IFAC; Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime; Rregullore e brendshme "Mbi procedurat e auditimit në KLSH";
- Rregullore e brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së".

- Metodat e auditimit. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me evidence dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Audituesit kanë aplikuar auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, mbi bazën e riskut të vlerësuar. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, janë marrë në konsideratë dy elementë:
Risku i lidhur me shpenzimin specifik dhe pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit. Nga ana e grupit të auditimit janë kryer vlerësimet mbi procedurat, mbi këto aspekte si më poshtë: *Kontrolli aritmetik*. *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. *Kontrolli i vlerësimit*. *Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi*. Intervista *Raporte dhe Informacione, të trajtuara në aktin e konstatimit mbi auditimin e PFV.*
U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.
Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja . Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e

marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

- Dokumentimi i auditimit. Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualet e auditimit financiar, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme.

Me shkresën nr. 5008/1 Prot, datë 13.07.2026, nga subjekti audituar Bashkia Librazhd është konfirmuar se nuk ka observime mbi Projekt Raportin e Auditimit, dhe se komentet janë paraqitur në fazën e akt konstatimeve. Nga grupi i auditimit të KLSH-së, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi. Rezultatet e këtij raporti përfundimtar, referuar evidencave të marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Bashkia Librazhd kufizohet në veri me Bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jug me Bashkinë Përrenjas dhe në perëndim me Bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit. Sipas Censusit të vitit 2023, Librazhdi ka një popullsi prej 23,312 banorësh. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 793.36 km^2. Densiteti i popullsisë është 55.68 banorë/km^2.

Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, si: Librazhdi, Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stërblevë, Polis dhe Orenjë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit, e cila ka nën administrimin një qytet dhe 52 fshatra.

Bashkia e re e Librazhdit ka potencial për zhvillimin e turizmit malor, por një gjë e tillë ka qenë jashtë vëmendjes së drejtuesve vendorë deri më sot. Mbrojtja e parkut kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe përfshirja e tij në guidat e turizmit malor në vend do të krijonte një perspektivë të re zhvillimi për Librazhdin dhe banorët e këtyre zonave. Paralelisht me resurset natyrore, zona e Librazhdit shquhet për folklorin e pasur, kostumet popullore të veçanta dhe zanatin e ndërtimit të shtëpive. Kjo zonë ka kultivuar gjithashtu mjeshtërinë e përpunimit të gurit dhe të drurit.

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare *(të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).*

Objektivat, burojnë nga ligji "Për vetëqeverisjen vendore".

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni, ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet. Njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive

themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.
Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.
Bashkia Librazhd, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

2. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

2.1.1. *Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për periudhën viti 2025.*

I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":
Në lidhje me parimin 1 "*Angazhimin për integritet dhe vlerat etike".*
Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit. Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Bashkia Librazhd funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Librazhd, të miratuar me shkresën me nr. 639 Prot, datë 01.02.2024.
Kodi Etik për Bashkisë Librazhd është miratuar me shkresën me nr. 2301, Prot, datë 02.05.2024.
Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë Bashkisë Librazhd, ato regjistrohen pranë Zyrës së Koordinatorit të së drejtës së informimit dhe të drejtës me publikun me një ndalesë, nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtoritë përkatëse dhe dhënia e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore".
Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë", si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, çdo drejtori ka kryer vlerësimin e punonjësve të saj 6 mujor, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar.
Në lidhje me parimin nr. 2 "*Titullari demostron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje*".

Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.
Për vitin 2025, përveç Drejtorisë së Buxhetit dhe Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, nuk rezultojnë të ishin hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit. Mosveprime në kundërshtim me përcaktimet e aneksin IV në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi: *N.B. me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore, Hysni Hoxha drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, E.K., drejtor i Drejtorisë së Funksioneve, A.G. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, L.SH. drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, K.B. drejtor i Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe Pronës, V.K. drejtor i Drejtorisë së Integrimit dhe Projekteve me BE*.

Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE. Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.
Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 "*Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë*".
Për vitin 2025, Bashkia Librazhd ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me nr. 80 Prot, datë 08.01.2025. Sipas kësaj strukture, administrata e bashkisë, ka 456 punonjës, 95 prej të cilëve nëpunës civil dhe pjesa tjetër të punësua me Kod Pune.

Në lidhje me parimin 4 "*Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave*".
-Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Librazhd nuk ka hartuar një plan trajnimesh për personelin e institucionit, si dhe nuk ishin kryer trajnime të brendshme për vitin 2025 në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1.
Për sa më sipër mban përgjegjësi, N.B., Drejtor i Burimeve Njerëzore.

Nga verifikimi i disa prej dosjeve të personelit, u konstatua se:
- Në dosjen peraonale të L.H., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025 si dhe certifikata personale; - Në dosjen personale të N.K., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025 certifikata personale certifikata familjare si dhe lista e notave; - Në dosjen personale të R.H., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025 dhe certifikata personale; - Në dosjen personale të D.B., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025, certifikata personale si dhe lista e notave; - Në dosjen personale të M.M., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025, certifikata personale si dhe lista e notave; - Në dosjen personale të A.B., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025 si dhe certifikata personale; - Në dosjen personale të F.M., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025 si dhe lista e notave; - Në dosjen personale të K.LL., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025 si dhe certifikata personale; ë dosjen personale të A.H., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025 si dhe certifikata personale; - Në dosjen personale të E.N., mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë për vitin 2025 si dhe certifikata personale.
Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se nuk është realizuar përshkrimi i pozicioneve të punës, veprime në kundërshtim me pikën 3 të Kreut II, lidhjen 2 të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, dhe administrimin e dosjeve të personelit të regjistrit qendror të personelit", VKM nr. 124, datë 17.02.2016 (i ndryshuar me VKM nr. 747, datë 19.12.2018) " Për pezullimin dhe lirimin nga Shërbimi Civil" kreu III, pika 23, paragrafi 2 VKM nr. 142, datë 12.3.2014, pika 13 dhe pika 16.

Për sa më sipër mban përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore znj. N.B..

-Me shkresën me nr. 5627 Prot datë 21.08.2025 është miratuar Plani Vjetor për Pranimin në Shërbimin Civil nga Kryetari i Bashkisë M.D.

Për Bashkinë Librazhd në vitin 2025, Nëpunësi Autorizues (NA) ka qenë Sekretari i Përgjithshëm B.P. Ndërsa detyrat e Nëpunësit Zbatues (NZ) është mbuluar nga Drejtori i Financës, A.H. dhe koordinatori i riskut për Bashkinë Librazhd, është caktuar z. B.P, i cili mban edhe detyrën e nëpunësit autorizues.

-Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).

Me shkresën me nr. 230 Prot, datë 15.01.2025, Kryetari Bashkisë Librazhd, M.D. ka ngritur Grupin për Menaxhimin Strategjik për vitin 2025 me përbërje: *B.P, drejtues i GMS, A.H. sekretar, E.S., K.B., H.H., N.B., L.SH., E.A., A.B., A.G., V.K.*.

II. Komponenti"Menaxhimi i Riskut"

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se ishte hartuar dhe miratuar regjistri i riskut dhe strategjia e riskut për vitin 2025.

Në lidhje me parimin 7: "*Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave*".

Në Bashkinë Librazhd Drejtoria e Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se nuk është miratuar gjurma e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Në lidhje me parimin 8: "*Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime*".

Me Urdhrin nr.858 datë 15.09.2023 "*Për ngritjen e Strukturës Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*" Kryetari i Bashkisë Librazhd, M.D. ka ngritur Njësinë e Sinjalizimit për Bashkinë Librazhd, duke caktuar R.M. si person përgjegjës, si dhe ka miratuar rregulloren përkatëse për rastet e sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të sinjalizuesve.

Në lidhje me parimin 9: "*Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm*".

Bashkia Librazhd në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk ishte hartuar dhe miratuar plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (me afat 5 vjeçar) të Bashkisë Librazhd sipas përcaktimit në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".

III. Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit"

Në lidhje me parimin 10: "*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli*".

Bashkia Librazhd ka hartuar dhe miratuar hartën e proceseve të punës. Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.

Për menaxhimin e aktiveve nuk veprohej në bazë të Udhëzimit të MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga

përgjegjësit Librazhd. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.
Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Librazhd.
Bashkia Librazhd në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponilibiteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: "*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë*".
Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up). Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Librazhd, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT.

Në lidhje me parimin 12: "*Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave*".
Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Financës.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"

Në lidhje me parimin 13: "*Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor*".
Bashkia Librazhd ka faqen e saj zyrtare në internet me adresë https://www.bashkiaLibrazhd.gov.al/ Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.
Në lidhje me parimin 14: "*Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor*".
Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Ky konstatim edhe si rrjedhojë e mungesës së trajnimeve të brendshme për punonjësit e niveleve të ndryshme të këtij institucioni.
Në lidhje me parimin 15: "*Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm"*.
Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejt me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/e-mail.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

Në lidhje me parimin 16: "Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme".
Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.
Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të

zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit.
Bashkia Librazhd lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE për vlerësimin e sistemeve për vitin 2025 me shkresën me nr. 8019/1 Prot datë 27.02.2026. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrolli të Brendshëm paraqet probleme në 5 komponentët e MFK. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për problematikat e pacaktuara.
Në lidhje me parimin 17: "*Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë*".
"Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë". Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

2.1.2 Organizmi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

Struktura e njësisë AB për vitin 2025

Nr.	2025	Funksioni	Arsimimi	vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme
1	R.M.	Përgjegjës AB	I Lartë	39	4	JO	2
2	T.H.	Specialiste	I Lartë	9	2.5	Në Proçes	1
3	D.H.	Specialist	I Lartë	21	2	Në Proçes	2
4	D.I.	Specialist	Vetëm Bachelor	2.5	1.9	Në Proçes	1

Burimi: *Bashkia Librazhd*

<u>Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për periudhën 2025.</u>
Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, nga Sektori i Auditit të Brendshëm ishte planifikuar të kryheshin 10 misione auditimi, konkretisht: Auditimit i zbatimit të rekomandimeve të lëna në vitin 2024, Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale Sektor (Detyrimet e Prapambetura dhe Sektori i Planifikimit të Buxhetit, Sektori i Shërbimeve Sociale, Agjencia e Funksioneve të Patransferueshme, Sektori i Tarifave dhe Taksave Vendore, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia e Shërbimeve, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Me shkresën me nr. 5705 Prot datë 25.08.2025, NJAB i ka dërguar shkresë MFE, me qëllim njoftimin për shtimin e një misioni tjetër të auditimit, konkretisht Sektorin e Emergjencave Civile.
Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se janë realizuar auditimet si vijon: Klubi i Sopotit SH.A, Biblioteka e qytetit, Sektori i Shërbimeve Sociale, Sektori i Mbrojtjes Civile, Sektori i Menaxhimit të Pyjeve Kullotave, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit Financiar (Detyrimet e Prapambetura). Shmangia nga Plani vjetor është argumentuar në Raportimin e NJAB për Drejtorinë e Harmonizimit në MFE nëpërmjet shkresën me nr. 883 Prot datë 12.02.2026.

Auditimet e kryera janë të paraqitura në tabelat si vijojnë

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT		
		Auditim të planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit

				Përputh	Financ	Kombi	Performace	Të tjera
2	Viti 2025	10	10	8	1	1	0	0

Nr.	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE NE NUMER										
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig.shoq, sig.shendetesore, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit prones, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Ssitemet e legalizimeve,uUrbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, suvencioneve	Të tjera (Të ardhura)	Audituesi mbuluar me auditim
1	Auditimi i Rekomandimeve Viti 2024											
2	Drejtoria e Taksave ,Tarifave Vendore dhe Tregjet											
3	Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit Financiar											
4	Drejtoria e Shërbimit Social											
5	Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve											
6	Sektori i Menaxhimit dhe i Mbrojtjes së Pyjeve											
7	Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit											
8	Biblioteka e Qytetit											
9	Sektori i Mbrojtjes Civile											
10	Klubi i Sportit " Sopoti "sh.a		**1**								**1**	

Nr.	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMIT NE VLERE									
		Prokurim, blerje & investime	Paga, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig.shoq, sig.shendetesore, përkujdesje shoqërore	Tatime, taksa, dogana	Administrim prone, pasurie	Privatizime, shitje, qiradhënie	Koncesione, ankande	Legalizime, Urbanistikë, kthim pronash	Kreditim, suvencione	Të tjera	Audituesi mbuluar me auditim
1	Auditimi i Rekomandimeve Viti 2024											
2	Drejtoria e Taksave ,Tarifave Vendore dhe Tregjet											
3	Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit Financiar											
4	Drejtoria e Shërbimit Social											
5	Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve											
6	Sektori i Menaxhimit dhe i Mbrojtjes së Pyjeve											
7	Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit											
8	Biblioteka e Qytetit											
9	Sektori i Mbrojtjes Civile											
10	Klubi i Sportit " Sopoti "sh.a		**297,000**								**15,000**	

Plani strategjik dhe i punës 2025-2027 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 5006 Prot, datë 18.10.2024, i cili është rishikuar dhe dërguar në MFE me shkresën me nr. 4507/1.

Për aktivitetin e vitit 2025 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 883 Prot, datë 12.02.2026.
Karta e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Librazhd ishte hartuar dhe miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë, nr.263, datë 16.01.2025.

Për vitin 2025 nga auditimet janë dhënë rekomandime, si më poshtë:

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT			
		Rekomandime te shprehura ne numër			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
2	Viti 2025	78	30	28	20
TOTALI					

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua se:
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me nenin 12, pika b) e Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", *përgjegjësi e Kryetari i Bashkisë Librazhd, M.D.*.
- Për vitin 2025, Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me përbërjen: Një Drejtor dhe 3 Specialist, ku niveli profesional i punonjësve nuk është sipas përcaktimeve të bëra në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik". Sipas këtyre dispozitave numri i punonjësve të pa certifikuar si "Auditues i Brendshëm" nga autoritetet përkatëse, nuk mund të kalojë 1/3 e numrit total të punonjësve në Njësinë e Auditimit, ndërkohë që asnjë prej punonjësve të NJAB nuk është pajisur me pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm.

Për periudhën viti 2025, u konstatua se nuk janë mbuluar me auditim aktivitetet që kryen Bashkia Librazhd, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si p.sh. Drejtoria Juridike dhe ajo e Prokurimeve, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.1 dhe pika 3.2
- Nuk ishte hartuar Programi i Sigurimit të Cilësisë në kundërshtim me Kapitullin X1 të Manualit të Auditit të Brendshëm.
-Nuk janë krijuar dosjet e përhershme të subjekteve të audituara, veprim në kundërshtim me paragrafin 6.3. të Manualit për Auditimin e Brendshëm.
Për sa trajtuar më sipër mban përgjegjësi: përgjegjësi e Kryetarit të Bashkisë M.D. dhe Drejtorit të Njësisë së Auditit të Brendshëm, R.M..

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Çështjet e audituara:

2.1. Programimi PBA 2025-2027 dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2025;
2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;
2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.);
2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor;

Dokumentacioni i audituar:

- Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministritë e Linjës;

- Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MF, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
- Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;
- Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
- Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendimeve gjyqësore;
- Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimit të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
- Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
- Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin "Excel", si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

- ***Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2025:***

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2025-2027, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik sipas urdhrit të Titullarit të institucionit me nr. 33 Prot, datë 15.01.2025, deri në organizimin e mbledhjeve të këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve.
Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e ndotjeve, garantimin e cilësisë në tregjet publike dhe rritjen e sigurisë në rrugë, përmirësimin e kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimin e shërbimeve sociale, mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e transportit publik dhe turizmit. Është bërë analiza e pagave dhe është llogaritur pesha specifike e këtyre llojeve të shpenzimeve në totalin e shpenzimeve.
Fushat me prioritet në shpenzimet për investime konkretisht:
a. Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit;
b. Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes;
c. Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;
d. Ndërtimi i veprave të mëdha publike;
e. Përmirësimi i kushteve për turizmin;
f. Mbështetja s e sipërmarrjeve te vogla;
g. Zhvillimi i zonave ekonomike, etj.;
Programet afatmesme ishin hartuar bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e PBA-së vendore periudha 2025-2027". Në hartimin e këtyre programeve është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit),* tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).*
Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "*Buxhetit me pjesëmarrje*", sipas datave të paraqitura në *Aneksin 2.1, b/lidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit (RPA).*
Buxhetet ishin hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative/ drejtoritë e shkollave/ sektorët e bashkisë/ ujësjellësi, etj., gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritet.

- ***PBA-të periudha 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025 .***

Për periudhën raportuese 2025, Titullari Bashkisë Librazhd në zbatim të kuadrit ligjorë për zbatimin e buxhetit, ka miratuar hapat për përgatitjen e kalendarit për programin buxhetor afatmesëm (2025-2027).

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në (15) programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA janë përcaktuar "*Përshkrimi i çdo programi*"; "*Politika e programit*"; "*Qëllimi Politikës së programit*"; "*Objektivat e politikës së programit*".

Për vitin 2025, buxheti bazë/fillestar vjetore (*në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor*), është miratuar me Vendim të KB nr. 108, datë 27.12.2024, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën me nr. 8/1 Prot, datë 15.01.2025, dhe buxheti i të trashëguara është miratuar me Vendim të KB me nr. 03, *(Prot 670, dt. 4.2.2025),* datë 31.01.2025, konfirmuar nga Prefekti I Qarkut Elbasan me shkresën me nr. 194/1 Prot, datë 12.2.2025.

Planifikimet sipas PBA-ve dhe ndryshimet janë paraqitur në **Tabelën B.1**, si vijon:

Planifikimet sipas PBA-ve dhe ndryshimet

Në lekë

Emërtimi	Buxheti 2025 PBA		Ndryshimi	
	Të Ardhurat	Shpenzimet	Të Ardhurat	Shpenzimet
Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës			37,532	
Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës			102,220	
Trashëguar nga Transferta specifike			24,126	
Plani i të ardhurave viti ushtrimor	179,117		220,385	
Granti	370,990		440,676	
Transferta specifike	160,232		202,917	
Paga (600)		303,271		416,113
Sigurime shoqërore (601)		48,255		68,178
Shpenzime operative (602)		137,759		173,639
Transferta (604-609) Fondi Rezervë		35,395		49,221
Inv (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez		185,659		320,706
Investime nga FZHSH e M. Linjës				
Te tjera (166, 651, 603,)				
Totali	**710,339**	**710,339**	**1,027,857**	**1,027,857**

Burimi: *Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH*

Sipas të dhënave të pasqyrës, konstatohet se për vitin 2025 me të ardhurat e veta bashkia mbulon 23.4% të shpenzimeve. Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore dhe është miratuar nga Këshilli i Bashkisë me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2025, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me Degën e Thesarit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet. Po kështu rezultoi se janë bërë argumentimet e transferimeve të ndryshme të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

- ***Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura****:*

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe

fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (*shtesa/pakësim*). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB, *sipas Aneksit 2.2, b/lidhur RPA.*

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve dhe realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës. Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*".

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë raportuar periodikisht pranë MFE.

Situacionet e shpenzimeve janë plotësuar sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Gjatë vitit 2025, buxheti i Bashkisë Librazhd ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve, si dhe të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Librazhd.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduar me Degën e Thesarit dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave të Bashkisë dhe të granteve. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Librazhd janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive. Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve. Gjatë auditimit, rezultoi se Kryetari i Bashkisë ka raportuar normalisht në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare, sipas përcaktimeve të nenit 64 të Ligjit nr. 30/2015 dhe Ligjit nr. 139/2015 dhe Udhëzimit të MF nr. 1, datë 9.1.1996 "Për procedurat e punës në sistemin e thesarit dhe institucioneve buxhetore" dhe Udhëzimin e MF nr. 2, datë 27.1.1999 "Për urdhër shpenzimet dhe titullin e të ardhurave".

- ***<u>Auditim mbi saktësinë e realizimit të trequesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit</u>.***

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuara nga transferta e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.
Nga të dhënat konstatohet se niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 72% deri 98% (sipas zërave), gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Librazhd dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara. Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë pagat dhe sigurimet me 29%, e ndjekur nga shpenzimet për Investimet me 27%.
Të ardhurat e veta të Bashkisë Librazhd për vitin 2025 janë realizuar në masën 76%, konkretisht nga vlera 214,268 mijë lekë të parashikuara (me ndryshime gjatë vitit) është realizuar vlera 163,800 mijë lekë, me një diferencë prej 50,468 mijë lekë.
Të ardhurat e trashëguara nga viti 2024 në vitin 2025 janë 37,532 mijë lekë;
Të ardhura të trashëguara nga grand i pakushtëzuar dhe transfertat viti 2024, në vlerën 126,346 mijë lekë;
Transferta e pakushtëzuar e vitit 2025 është në shumën 473,863 mijë lekë;
Transferta specifike sektoriale është në shumën 212,405 mijë lekë;
Transferta të kushtëzuara në shumën 713,381 mijë lekë.
Shpenzimet për vitin 2025 janë parashikuar në vlerën 1,776,797 mije dhe janë realizuar në vlerën 1,570,315 mije leke ose në masën 88%, sipas **Pasqyrës B.2,** si vijon:

Pasqyra B.2: *Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2025, referuar akt-rakordimeve me thesarin (pa njësitë e varësisë).*

Në/000 lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Librazhd, për vitin 2025									
				Burimi i financimit të shpenzimit					
						Nga Granti Qeveritar			
Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Nga të ardhurat e veta	Mjete ne ruajtje 466	Nga transferta e pakushtëzuar	Nga transferta e kushtëzuar specifike	Nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transferta e kushtëzuar për investimet
Paga 600	442,090	403,151	61%	3,547		235,458	156,550	7,595	
Sigurime shoqërore 601	73,355	66,247	90%	230		38,783	25,848	1,386	
ShP. Operat 602+ F. Rezervë	181,321	132,852	73%	47,061		77,970	5,446	2,375	
Subvencion Ujësjellësi, etj. 603									
K. Q Emergj Civile 604	29,417	28,843	98%	2,412		21,710		4,721	
Nd/Ekonom invalid 606	513,116	505,802	99%			5,644		500,157	
Mjete ne ruajtje 466		6,032			6,032				
Investime 230-231	537,496	427,388	80%	123,470		129,296	5,989	168,634	
Totali	**1,776,797**	**1,570,315**	**88%**	**176,720**	**6,032**	**508,862**	**193,833**	**684,868**	

Burimi: *Bashkia Librazhd, përpunoi grupi auditimit*

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025, referuar akt-rakordimeve me thesarin, është paraqitur në **Tabelën B.3**, si vijon:
Pasqyra B.3: *Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025, referuar akt-rakordimeve me thesarin*

Në mijë lekë

Nr.	Institucioni	Plan	Fakt	%
1	Të ardhurat e vitit 2025	214,268	147,040	69%
2	Të ardhurat e trashëguara nga 2024	163,878	133,685	81%
3	Transf. pakushtëzuar 2025	473,864	427,807	90%
4	Transferta specifike 2025	212,405	170,883	80%
5	Transferta e deleguar	712,381	684,868	96%
6	Tjera		6,032	
Shuma		**1,776,796**	**1,570,315**	**88%**

Burimi: *Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit*

Sa sipër konstatohen diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitin 2025 të ketë mosrealizime.

Nga të dhënat, konstatohet se treguesit e buxhetit për vitin 2025 janë realizuar në masën 88%, gjë e cila tregon se planifikimi nuk është sipas nevojave që bashkia ka. Në nivel treguesish me realizmi më të ulët paraqitet pagat në nivelin 61 % e ndjekur nga shpenzimet operative në masën 73% dhe investimet në masën 80%. Sipas informacionit të marrë nga subjekti, ky mos realizim vjen për mungesë të realizimit të të ardhurave të parashikuara, gjë e cila vërteton atë që grupi i auditimit thekson në fillim se planifikimi i treguesve në buxhet nuk duhet bërë mbi bazë plani të të ardhurave (plan i cili gjatë vitit ka pësuar ndryshime), por në bazë të faktit të realizimit të tyre, gjë e cila më pas çon në mos realizimin e treguesve të buxhetit.

Burimi i financimit të treguesve, sipas tabelës, konstatohet se me të ardhurat e veta (176,720,013 lekë), ka mbuluar 11.2% të shpenzimeve, ndërsa me transfertat e pakushtëzuara (508,862,241 lekë), kushtëzuara specifike (193,832,810 lekë), kushtëzuara për funksione të deleguara (684,868,432 lekë), që në total janë në vlerën 1,387,563,483 lekë, ka mbuluar 88.3% të shpenzimeve, gjë e cila tregon se peshën kryesore në realizimin e shpenzimeve mbulohen nga të ardhurat e buxhetit qendror dhe jo të ardhurat e veta, kjo tregon vështirësie e kësaj bashkie në menaxhimin e të ardhurave.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 pika 1.3 germa "c" dhe "ç"; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 2 dhe 3 pika 3; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; Udhëzimin e MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 22.11.2016 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

- ***Miratimi i buxhetit faktik***.

Në fund të periudhës ushtrimore 2025, buxheti faktik nga Bashkia Librazhd është miratuar me Vendim të KB nr. 19 (Prot 898), datë 13.2.2026 konfirmim nga Prefekti Qarkut Elbasan me shkresën nr. 244/1 Prot datë 18.2.2026, bashkë me hartimin e PBA-së. Në relacionin përfundimtar të zbatimit të buxhetit është hartuar vetëm realizimi i treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk është shoqëruar me analizë faktoriale për realizimet e fondeve dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës.

Nga sa sipër buxheti është miratuar brenda afateve të përcaktuara në 44[2] të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Financat Vendore", i ndryshuar.

- ***Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak***.

Gjatë vitit 2025 ishin hartuar 3 raporte monitorimi sipas pikave 19, 20, 22 dhe 23 të Udhëzimit të MF nr.22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimi nr. 14 datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", si dhe udhëzimi plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", konkretisht :

- Raporti monitorimit të buxhetit Janar-Prill 2025 shkresë nr.3663 Prot datë 21.05.2025.
- Raporti monitorimit të buxhetit Janar-Gusht 2025 dërguar me postë elektronike (sipas kërkesës Ministrisë Financave) datë 24.09.2025
- Raporti monitorimit të buxhetit Janar-Dhjetor 2025 dërguar me postë elektronike(sipas kërkesës Ministrisë Financave) datë 13.02.2026.

- ***Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.***

Sipas të dhënave nga Drejtoria Ekonomike, rezulton Fond rezervë në vlerën 17,279 mijë lekë, fondi kontigjencës në vlerën 2,000 mijë lekë dhe i emergjencës në vlerën 8,640 mijë lekë.

Fondi Rezervë: Në buxhetin e vitit 2025 është planifikuar në vlerën 17,279 mijë lekë, shtesë gjatë vitit në vlerën 252 mijë lekë, dhe është përdorur 17,078 mijë lekë, si më poshtë:

- Vendim të KB nr. 22 dt.26.02.2025 "*Për Blerje, zhvillim, prodhim ose bashkëprodhim i materialeve të synuar për shërbime të medias audiovizive ose shërbime të medias radiofonike për bashkinë Librazhd me natyrë arsimore ,kulturore dhe infrastrukturore*" në vlerën 500 mijë lekë;
- Vendim të KB nr. 24 dt.26.02.2025 për "*Miratimin e marrëveshjes nr.1008 datë 19.02.2025 "Shërbimet Sociale për të gjithë*" në vlerën 212 mijë lekë;
- Vendim të KB nr. 39 dt.28.05.2025 për "*Bashkëfinancim Ndërtim infrastrukture për të rinjtë e Librazhdit*" në vlerën 6,158 mijë lekë;
- Vendim të KB nr. 40 dt.28.05.2025 për "*Bashkëfinancim tërsorë dhe rindërtim i palestrës së shkollës Vilson Blloshmi*" në vlerën 3,234 mijë lekë ;
- Vendim të KB nr. 41 dt.28.05.2025 "*për financimin e akt-marrëveshjes montim ure tip Bailly në fshatin Polis Sheh Nj.Adm.Polis*" në vlerën 286 mijë lekë;
- Vendim të KB nr. 67 dt.29.07.2025 "*për financimin e ndërtimit të dy shtëpive për dy familje me vështirësi ekonomike*" në vlerën 1,400 mijë lekë ;
- Vendim të KB nr. 69 dt.29.07.2025 për "*Bashkëfinancim përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara 2025-2026*" në vlerën 3,423 mijë lekë;
- Vendim të KB nr. 86 dt.30.09.2025 për "*Prodhim, transport, ngarkim, pastrim, stivim material drusor në ekonominë pyjore Dardhë- Xhyrë dhe Neshtë -Prevallë*" në vlerën 1,265 mijë lekë;
- Vendim të KB nr. 93 dt.28.10.2025 për "*Dhënie ndihmë financiare G.B*" në vlerën 500 mijë lekë;
- Vendim të KB nr. 97 dt.28.10.2025 për "*Dhënie ndihmë financiare F.B*" në vlerën 100 mijë lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit, rezultoi se shpenzimet janë kryer në përputhje me kuadrin ligjore, me procedura prokurime me vlerë të lartë dhe të vogël.

[2] Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars (bëhet 31 maj, sipas ligjit 38/2019, dt. 206.2019), e vitit pasardhës.

Fondi i Kontingjencës: Në buxhetin e vitit 2025 është planifikuar në shumën 2,000 mijë lekë. Me Vendim të KB nr. 73, datë 29.08.2025 për "Për disa ndryshime në VKB nr.108 datë 27.12.2024 Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027, VKB nr.3 datë 31.01.2025 Për një shtesë në VKB nr. 108, datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027" në vlerën 2,000 mijë lekë, përdorur për paga dhe sigurime shoqërore për bashkinë, si rezultat i ndryshimeve për paga.

Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile: Në buxhetin e bashkisë janë parashikuar fonde për emergjencën në shumën 8,640 mijë lekë, të cilat janë përdorur si vijon:

- Vendim të KB nr. 84 datë 30.09.2025 për "*Ndërtim bazamente për ure tip "Baily*" HD 30 ML me seksion 1/1 Njësia Administrative Orenje Bashkia Librazhd " në vlerën 5,000 mijë lekë;
- Vendim të KB nr.85 dt.30.09.2025 për "*Mbështetje financiare për përballimin e fatkeqësisë së krijuar nga zjarri për bashkinë Gramsh*" në vlerën 2,000 mijë lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit, rezultoi se shpenzimet janë kryer në përputhje me kuadrin ligjore.

- ***Realizimi i Investimeve*.**

Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve të planifikuara paraqitet në masën 79%, ku nga vlera e planifikuar prej 537,496 mijë lekë është realizuar vlera 427,386 mijë lekë *me një diferencë prej 110,110 mijë lekë.*

Sipas përfaqësuesve të Bashkisë Librazhd *(Drejtoria Financë/Buxhet),* ky mosrealizim vjen si pasojë e mungesës së të ardhurave të realizuara sipas periudhave ushtrimore, por sipas grupit të KLSH-së, kjo vjen nga planifikim i procedurave pa fonde në dispozicion, pasi në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve ose planifikimi i tyre behët në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat variojnë në nivelet e 76-80%, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura *(investime/ shërbime/blerje mali)*, në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre.

Gjithashtu, në planifikimin e buxheteve për investime, konstatohet se të gjitha investimet janë planifikuar me afat pagese nga 2 - 3 vjeçare, të cilat janë miratuar në PBA respektive, por referenca ligjore që ato i kanë mbështetur këto financime nuk qëndron, pasi nuk janë investime të reja dhe kontrata shumëvjeçare[3], por janë investime (*kryesisht rikonstruksione*), dhe në vlera të vogla që variojn nga 10 deri në 30 milionë lekë dhe se afati i zbatimit të kontratave varion nga 2 muaj deri në 5 muaj, pra mbyllja e kontratave është brenda vitit kalendarik.

Këto veprime janë kryer nga Bashkia Librazhd, për të rritur numri e procedurave të prokurimit në një vit buxhetor, por nga pikëpamja financiare çon në rritjen e nivelit të kreditorëve (*fatura të palikujduara*), pasi një pjesë e madhe e vlerës së faturave mbi 25% lihet për likuidim në periudhat e ardhshme, duke penguar në një farë mënyrë prioritet që mund të ketë bashkia në periudhën në vijim, kjo për faktin se fillimisht planifikohen faturat e palikujduara të periudhave të mëparshme dhe më pas planifikim i procedurave të reja. Po ashtu në disa raste nuk është ruajtur dhe niveli 20% e fondit të planifikuar në vitin ushtrimorë.

Sa sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27, 32, 50-51; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 pika 1.3 germa "c" dhe "ç"; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 2 dhe 3 pika 3 dhe neni 47; pika 101

[3] Zbatimi i kontratave shumëvjeçare, ka lidhje me investimet e reja publike me kontrata shumëvjeçare dhe financim deri në 3 vjet, dhe jo me kontratat ku vlera e projekti është shumë e vogël dhe nuk janë investime.

dhe 102 të Udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, nenet 79, 80.

- ***Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve***.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Me fondet e vitit buxhetor 2025, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHSH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.
Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive është paraqitur e detajuar në **Tabelën B.4**, si vijon:

Pasqyra B.4: *Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara*

Në mijë lekë

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës 31.12.2025	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr.108 /datë 27.12.2024	Llog. 602	Llog. 230-231
2025	3,740	3,740			3,740

Burimi: *Bashkia Librazhd.*

Në totalin e faturave të palikuiduara për vitin 2025, faturat e artikullit 230-231 paraqiten në shumën 3,740 mijë lekë. Gjithashtu, konstatohet se në fund të vitit 2023, vlera e detyrimeve te planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël, nisur nga fakti se planifikimi i buxhetit të vitit pasardhës hartohet dhe miratohet në muajin nëntor dhe detyrimet nuk kanë dalë të gjitha. Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar edhe të dhënave të rubrikës "*Detyrimet e prapambetura*", sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura janë paraqitur të detajuara në **Tabelën B.5**, si vijon:

Pasqyra B.5: *Zhvillimi i shumës së detyrimit të prapambetur në fund të vitit 2025*

Në lekë

Nr.	Financimi	Vlera e detyrimeve më datë 31.12.2024	Shtesat gjatë vitit 2025	Likuiduar përgjatë vitit 2025	Vlera e detyrimit më datë 31.12.2025
1	Investime granti				
2	Investime të ardhura	6,023,679	3,740,089	6,023,679	3,740,089
3	Shërbime nga granti	100,000		100,00	
4	Shërbime nga të ardhurat				
Totali		**6,123,679**		**6,123,679**	**3,740,089**

Burimi: *Bashkia Librazhd***.**

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikuiduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, *rezultoi se* detyrimet e raportuara janë në vlerën 3,740 mije lekë. Ndërsa gjendja e detyrimeve të palikuiduara në fund të vitit 2025 sipas pasqyrës financiare paraqitet në vlerën 54,392,684 lekë, *nga e cila:* në llogarinë llog 401-408 në vlerën 7,367,917 lekë dhe llogarinë 467 në vlerën 47,024,767 lekë, pra me një diferencë prej 50,651 mije lekë, të cilat janë fatura nën afatin 60 ditë nga data e prerjes së tyre.

- *Faturat e pa likuiduara***.**

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 60 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2025 nuk ka fatura të papaguara jashtë afatit 60, pasi të gjitha faturat janë brenda këtij afati, ku sipas periudhave janë paraqitur të detajuara në *Aneksin 2.3, b/lidhur RPA.*

Pasqyra B.6 (shprehur ne lekë)

Llog. 602		Llog. 230-231		Shuma	
Sasia	**Vlera**	**Sasia**	**Vlera**	**Sasia**	**Vlera**
18 fatura	***8,132,831***	9	**46,259,853**	27	**54,392,684**

Burimi: *Bashkia Librazhd : Vlere e kuadruar ne pasqyrat financiare viti 2025*

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe audituar nga grupi i KLSH, rezultoi se nga Bashkia Librazhd *(Drejtoria e Financë/Buxhet)*, ka një sasi faturash të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizmi i të ardhurave vendore. Kështu për vitin 2025, paraqiten gjithsej **3** fatura me vlerë **12,949 mijë lekë**, konkretisht **Pasqyra B.7**, si vijon:

Pasqyra B.7: *Fatura të likuiduara pjesërisht (shprehur në lekë)*

Nr.	Nr. / fature	Subjekti	Nr. USH	Vlera	Diferenca
1	45962/ 31.10.2025	A...	Blerje fadrome	11,868,000	5,148,000
2	47/2025, dt. 13.11.2025	R...	Asfalti i rrugës Merqize Nj.Ad qendër	8,000,000	4,061,673
3	27/2025, dt. 12.06.2025	L...	Sistemim Asfaltim i Rrugës Se Fshatit Vehcan Faza 1	16,648,291	3,740,089
Shuma					**12,949,762**

Burimi: *Bashkia Librazhd*

- ***Situata financiare e bashkisë Librazhd, viti 2025.***

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, mbi gjendjen e faturave të palikujduara në fund të periudhës vjetore, konstatohet se kjo bashki nuk rezulton me vështirësi financiare për vitin 2025, pasi përqindja e faturave të palikujduara në raport me shpenzimet është në nivelet 1.14%, siç tregohet në *Aneksin 2.4, b/lidhur RPA.* Ndërsa për ministritë e linjës vlera e detyrimit të prapambetur, e raportuar në Raportin e monitorimit në MF nga bashkia Librazhd është si më poshtë vijon:

Në lekë

Detyrime pushteti qendror	Llogaria ekonomike	Vlera ne leke
Ministri linje17 01 10910 231 18AZ905	Blerje fadrome	5,148,000
FSHZH		

- ***Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës, detyrimet kontraktore dhe shpronësimet.***

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezultoi se deri në fund të vitit 2024 paraqitet gjithsej vlera prej 12,084,603 lekë. Gjatë vitit 2025 është shtuar për vlerën 824,555 lekë dhe likuiduar vlera prej 7,611,020 lekë, duke mbetur për likuidim vlera prej 5,298,138 lekë, që i përket vendime gjyqësore për largim nga puna për 3 punonjës.

Këto vendime gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet, veprime këto në kundërshtim

me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, pika 60. Gjithashtu, referuar informacionit të sipërcituar mbi planifikimin e faturave të papaguara, konstatohet se nga bashkia Librazhd nuk parashikohen në buxhetin e vitit vijues pagesa e vendimeve gjyqësore**.**

- ***Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor dhe përdorimi i tyre.***

Sipas informacionit të marrë në Drejtorinë Ekonomike, mbi të ardhurat e realizuara për vitin 2025 dhe mënyrën e përdorimit të tyre, kemi këtë situatë:

Pasqyra B.8. *Burimi i krijimit të të ardhurave (shprehur në lekë)*

EMERTIMI	VITI 2025		
	PLANI	FAKTI	GJENDJE
Të ardhurat e trashëguara, *nga të cilat:*	**163,879,078**	**133,685,324**	**30,193,754**
-Transferta e pakushtëzuar trashëguara	102,220,491	81,055,276	21,165,215
-Transferta Specifike të trashëguara	24,126,484	22,950,101	1,176,383
-Të ardhurat e veta	37,532,103	29,679,947	7,852,156
- Transferta e kushtëzuar			
- Donacion			
Të ardhurat e vitit ushtrimore, *nga të cilat:*	**1,612,918,415**	**1,430,598,172**	**182,320,243**
-Transferta e pakushtëzuar	*473,863,639*	*427,806,965*	46,056,674
-Transferta specifike	*212,405,207*	*170,882,709*	41,522,498
-Transferta kushtëzuar	*712,381,569*	*684,868,432*	27,513,137
-Të ardhurat e veta	*214,268,000*	*147,040,066*	67,227,934
Transferta kushtëzuar të Vitit ushtrimor, *nga të cilat:*			
- Nga FZHR			
- Nga donatore te ndryshëm			
- Nga ministritë e linjë			
- Invalit dhe ndihme ekonomike			
TOTALI	**1,776,797,493**	**1,564,283,496**	**212,513,997**

Burimi*: Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit*.

Referuar evidencës së fundviti rakorduar me degën e thesarit, rezultoi se në total të ardhurat e vitit janë parashikuar në vlerën 1,776,797 mijë lekë, nga e cila janë përdorur gjatë vitit 2025 vlera 1,564,283 mijë lekë dhe diferencë prej 212,513 mijë lekë shkon e trashëguar për vitin 2026. Referuar tabelës, për vitin 2025 të ardhurat e veta zënë 14.1% të totalit të të ardhurave të përdorura, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga grandet e shtetit (*transferta specifike/kushtëzuara dhe pakushtëzuara, donaciaone etj*.) si dhe donacione.

Nga të dhënat sipas zëra të shpenzime, konstatohet se të ardhurat e veta në masën 69.2% shkojnë për investime (231), dhe 26% për shpenzime operative (602). Gjithashtu më të ardhurat e veta bashkia mbulon 11.2% të totalit të shpenzimeve, ndërsa pjesë tjetër nga grandet qendrore, gjë e cila tregon performacën jo të mirë të realizmit të të ardhurat nga taksat e tarifat vendore, të dhëna të cilat paraqiten në tabelën **B.9**, *mëposhtëm*:

Pasqyra B.9. *Përdorimit i të ardhurave sipas destinacioneve (shprehur në lekë)*

Emërtimi	Fakt 2025			
	Gjithsej	Transferta Pakushtëzuar dhe Specifike	Te ardhurat e Veta	Transferta Kushtëzuar
600-Paga	403,150,949	392,008,379	3,547,312	7,595,258
601-Sigurime Shoqërore	66,246,733	64,631,100	229,868	1,385,765
602-Shpenzime Operative	132,852,456	83,416,394	47,061,081	2,374,981
603-Subvencion				
604-Transferta Brendshme	28,842,883	21,710,000	2,411,869	4,721,014
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	505,801,783	5,644,449		500,157,334
230-Projekte	3,049,678	1,979,620	1,070,058	
231-Investime	427,388,614	133,305,109	122,399,825	168,634,080
SHUMA	**1,570,315,223**	**702,695,051**	**176,720,013**	**684,868,432**

Burimi*: Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit*

Personi përgjegjës për hartimin dhe miratimin dhe zbatimin e buxhetit: ***A.H.****, me detyrë Drejtor Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe* ***E.C.*** *me detyrë Përgjegjës Sektori të Buxhetit.*

2.2.5. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifat, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Kuadri ligjor mbi menaxhimin e të ardhurave vendore:
Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar,
Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar,
Ligji nr. 9920/2008 datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar,
Vendimet e Këshillit Bashkiak Librazhd për miratimin e paketës/ve fiskale të vitit 2025, me ndryshime;
Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, ej.;
Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave;
Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifat vendore;
Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Sektori i të Ardhurave Vendore/tatim-taksave.
Struktura/t organizative e miratuar gjatë periudhës 01.01.2025-31.12.2025;
Rregullore e brendshme institucionale e miratuar;

- ***Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*:**

Struktura organizative e Bashkisë Librazhd e aplikuar për vitin 2025 është miratuar me Vendim te Kryetarit të Bashkisë Librazhd nr. 1 datë 30.01.2024 (me nr. Prot 693), me objekt "*Për miratimin e strukturës, organigramës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Librazhd*", në të cilën përfshihet Drejtoria e Ekonomisë, Financës, të ardhurat vendore dhe strehimit social. Në këtë Drejtori përfshihet sektori të ardhurave, e paraqitur, Pasqyra nr. 1:

Pasqyra nr.1: *Struktura e sektorit të tatim- taksave vendore për vitin 2025.*

Drejtoria e Taksa e Tarifa Vendore – viti 2025					
Nr.	**Emër Mbiemër**	**Pozicioni në strukturë**	**Profili Arsimor**	**Niveli**	**Periudha në pozicionin e punës**
1	L.SH.	Drejtor	Ekonomik	Lartë	15.06.2018
2	E.K.	Përgjegjës	Administrim biznes	-//-	02.05.2018
3	M.G.	Përgjegjës	Ekonomik	-//-	18.01.2019
4	E.F.	Specialist	Menaxhim agrobiznes	-//-	01.01.2023
5	E.C.	Specialist	Ekonomi dhe e drejta	-//-	30.01.2019
6	A.T.	Specialist	Administrim biznes	-//-	18.10.2021
7	G.H.	Specialist	Inxhinieri Mbrojtje mjedisi	-//-	23.11.2023
8	G.T.	Specialist	Marketing	-//-	01.08.2019

Burimi*: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit*

***- Paketa fiskale për vitin 2025*.**

Paketa fiskale viti 2025 është miratuar me Vendim të KB nr. 100, datë 27.11.2024 dhe nr. .1301/1 pro, datë 13.12.2024, konfirmim akti nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 108, datë 27.11.2024 "*Për Miratimin e buxhetit të vitit 2025*" dhe nr. 08/1 Prot , datë 15.01.2025, konfirmim akti nga Prefekti i Qarkut Elbasan.
Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 100, datë 26.11.2025 " *Për rritje dhe pakësim të planit buxhetor të vitit 2025*" dhe Nr. 1261/3 Prot, datë 29.12.2025, konfirmim akti nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Referuar të dhënave të akt-rakordimeve me degën e thesarit dhe evidencat e Drejtorisë së të Ardhurave për aktivitetin e vitit 2025, rezultoi se të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë realizuar në masën 76%, ku nga vlera e parashikuar prej 214,26 mijë lekë është arkëtuar vlera prej 163,800 mijë lekë, me një diferencë prej 50,468 mijë lekë. Për vitin 2024 realizimi i të ardhurave është 161,575,968 lekë. Ndërsa për vitin 2025 realizimi i të ardhurave është 163,800,758lekë. Duke krahasuar faktet e periudhave 2024/2025 shihet një rritje në vlerë prej 2,225 mijë lekë më shumë se viti 2024, siç tregohet ne *Aneksin 2.2.5.1, b/lidhur RPA.*
Sipas të dhënave të *aneksit 2.2.5.1 b/lidhur RPA*, kemi:
Të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar në masën 68%
Të ardhurat nga tarifat vendore janë realizuar në masën 92 %
Të ardhurat nga sektori i pyjeve dhe kullotave, janë realizuar në masën 72 %
Të ardhura të tjera janë realizuar në masën 67%.

Referuar të dhënave të *aneksit 2.2.5.1 b/lidhur RPA* me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:
a. "*Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale*", është planifikuar në vlerën 15,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 15,744 mijë lekë ose realizuar në masën 105%.
b. "*Tarife ndriçimi + Gjelbërimi*" është planifikuar në vlerën 3,700 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,786 mijë lekë ose realizuar në masën 102%.
c. "*Tarife për dhënie licencë e certifikate transporti*" është planifikuar në vlerën 310 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 448 mijë lekë ose realizuar në masën 145%.
d. "*Tarife parkimi*" është planifikuar në vlerën 1,353 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,536 mijë lekë ose realizuar në masën 114%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:
a. "*Gjoba nga I.M.T, Policia*" është planifikuar në vlerën 1,650 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 436 mijë lekë ose realizuar në masën 26%.
b. "*Tarifa për ushtrim aktiviteti dhe autorizime për karburantet*" është planifikuar në vlerën 3,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,400 mijë lekë ose realizuar në masën 47%.

Detyrimi i prapambetur i parashikuar nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025, është në vlerën 19,600 lekë.

- ***Mbi veprimtarinë e agjentëve tatimorë dhe rakordimet mujore*.**

Nga auditimi, u konstatua se në rregulloren e brendshme të Bashkisë Librazhd nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve. Gjithashtu, si rezultat i kësaj mungese, nuk janë mbajtur akt-rakordime çdo muaj në lidhje me numrin e personave që duhet të paguajnë, të personave që kanë paguar dhe personave të paguar.
DATTV nuk ka informacion nëse nga këto agjent ka diferencë të arkëtimeve të padredhura në llogaritë e bashkisë. Kështu mungojnë raportimet me DRT për tatimin e thjeshtuar dhe TAP, me DSHRR për numrin e mjeteve që duhet të paguajnë, të ASHK për transaksionet e shitblerjet, etj.
Të ardhurat e arkëtuara nga Agjentët Tatimorë në Bashkinë Librazhd janë paraqitur në *Tabelën nr. 2,* si vijon:

Nr.	Emërtimi	Plani 2025	Realizimi 2025	% e realizimit/planin
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (Agjenti DRT)	350,000	161,462	46
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (Agjenti DRT)	15,000,000	15,743,617	105

Nr.	Emërtimi	Plani 2025	Realizimi 2025	% e realizimit/planin
3	Taksa e regjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR)	17,700,000	17,331,020	98
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK)	250,000	30,500	12
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana.)	150,000	149,067	99
	Totali	**33,450,000**	**33,415,666**	**99.8**

***Burimi**: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit*.

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se nivelin më të ulët është taksa e kalimit të drejtës së pronësisë me 12% dhe tatim thjeshtuar i fitimit (DRT) me 46%, kjo vjen si rezultat ose i mos planifikimit të saktë të të ardhurave për këto zëra duke mos marrë informacion nga agjentët përkatës, ose mos kryerja e saktë e akt-rakordimeve mujore/vjetore mbi veprimtarinë që subjektet ose personat privat kryerje aktivitet tregtarë të DRT dhe transaksionet e shitblerjes në ASHK.

Në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, u konstatua se nga Bashkia Librazhd nuk është krijuar një bazë të dhënash e plotë dhe e saktë, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është bërë asnjëherë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Librazhd, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga dega e Thesarit.

Sa më sipër, në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, Ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; Ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe Udhëzimin e MF nr. 12, dt. 4.4.2017, "Për Taksat Kombëtare", etj.

- ***Lista e debitorëve të subjekteve fizik/juridik dhe abonentët familjarë për vitin 2025***.

1. Biznesi fizik/ juridik , ambulante, ndërtesa social ekonomik dhe kontratat.
2. Legalizimet
3. Familjaret me agjent Ujësjellësin
4. Tregu i qytetit
5. Kontrata me fondin pyjor kullosor *(detyrimet për vlerën e kontratës janë përfshirë bashkë me detyrimet e tjera tek tabela Nr. 1).*

- ***Detyrimet e përmbledhura për abonentët familjarë dhe tarifat vendore***.

Referuar të dhënave të marra nga Dtejtoria e Taksave Vendore, Bashkia Librazhd mbi detyrimet tatimore në fund të perudhës 2025, paraqitet kjo situatë:

Në lekë

E m ë r t i m i	Në fillim të vitit 2025 (trashëguar nga vitet e mëparshme 2011-2024)		Krijuar brenda vitit 2025		Arkëtuar debitorë për periudhën 2011-2024		Në fund të vitit 31.12.2025	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Biznësi i Madh	83	28,627,339	42	9,071,555	36	8,443,447	78	29,255,447
Biznësi Vogël	302	13,625,180	150	2,421,793	81	2,404,645	310	13,642,328
Ndërtesat social ekonomike	91	6,493,131	90	2,029,416	52	3,593,951	99	4,928,596
Legalizimet	177	8,377,411	34	1,256,545	11	700,130	200	8,933,826
Familjet qytet	185	6,083,077	195	175,761	140	4,564,336	240	1,694,502
Familjet në 6 njesite administrative	5669	44,542,273	4987	7,908,321	944	4,008,224	5287	48,442,370
Debitore të tregut të qytetit	105	3,798,270	16	69,000	14	74,100	107	3,793,170
SHR UK Elbasan			0	0	0	0	0	183,034
SHUMA	**6,612**	**111,546,681**	**5,514**	**22,932,391**	**1,278**	**23,788,833**	**6,321**	**110,873,273**

Për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura të subjekteve ishte kryer procedura e mbledhjes me force e detyrimeve, ku procedura e parë është njoftim vlerësimi për detyrimet e prapambetura/papaguara, për biznesin e madh, biznesin e vogël, legalizimi, tregu, ndërtesat, kjo në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenet 88, 89, 90 dhe 91.
Njoftim Vlerësimi për biznesin e madh me listën emërore 116 biznese me vlerën *36,365,475 lekë*
Njoftim vlerësimi për biznesin e vogël, ndërtesa me qira, ambulante etj. me listën emërore 441 biznese me vlerën *23,092,200 lekë.*
Njoftim vlerësimi për objektet legalizuar me listën emërore 197 persona.
Njoftim Vlerësimi për tregtaret qe tregtojnë në tregun e qytetit me listën emerore106 me vlerën *3,814,470 lekë.*
Sipas procedurës se bërë si me sipër janë përgatitur Bllokimet e llogarisë, urdhër bllokimi, si me poshtë;
Bllokim i llogarive bankare sipas shkresës Nr. 4402 Prot , date 24.06.2025 sipas listës emërore me Nr. 426 subjekte biznesi madh i vogël, ndërtesa me qira social ekonomike, ambulante etj. në vlerën 39,874,445 lekë, shkresës nr. 5649 Prot, date 22.08.2025 sipas listës emërore me nr. 372 subjekte biznesi madh i vogël, ndërtesa me qira social ekonomike, ambulante etj. në vlerën *37,445,463 lekë.*
Vendosje barre hipotekore te Pasurive sipas shkresës Nr. 4404 Prot , date 24.06.2025 sipas listës emërore me Nr. 426 subjekte biznesi madh I vogël , ndërtesa me qira social ekonomike , ambulante etj. në vlerën *39,874,445 lekë.*
Vendosje mase se bllokimit te pasurisë në QKB , sipas shkrese Nr. 4403 Prot , date 24.06.2025 sipas listës emërore me Nr. 426 subjekte biznesi madh I vogël, ndërtesa me qira social ekonomike, ambulante etj. në vlerën *39,874,445 lekë.*
Vendosje barre sigurese te mjeteve te transportit , sipas shkrese Nr. 4405 Prot , date 24.06.2025 sipas listës emërore me Nr. 426 subjekte biznesi madh I vogël, ndërtesa me qira social ekonomike, ambulante etj. në vlerën *39,874,445 lekë.*
Theksojmë faktin se shumë subjekte debitorë që kanë mbetur ndër vite janë subjekte të cilët kanë mbyllur aktivitetin, janë larguar (pavarësisht se është zbatuar dhe procedura e masave shtrënguese), ose kanë ndërruar jetë etj. Me përfundimin e afatit 30.09.2025 të kryerjes së pagesës nga subjektet e biznesit te madh është kryer masa e parë e masave shtrënguese si njoftim vlerësimi për detyrimet e prapambetura me shkresë Nr. 7812 Prot, datë 20.11.2025 me listën emërore Nr. 104 subjekte me vlerën 32,676,876 lekë. Nga masat shtrënguese për subjektet e biznesit madh , vogël, ambulante, ndërtesa me qira etj. vlera debitorë nga 48,745,650 lekë, janë paguar gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025 në vlerën 14,366,997 lekë dhe mbeten *34,378,653 lekë*.
Në kuadrin e masave shtrënguese dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional ishin kryer dhe korrespodenca me institucionet dhe drejtoritë pranë bashkisë për të bërë të mundur vjeljen e debitorëve sipas shkresave nr. 8030 Prot , datë 04.12.2025 "*kërkesë për bashkëpunim*" me Qendrën Shëndetësore Hotolisht, Nr. 8028 Prot , datë 04.12.2025 "*kërkesë për bashkëpunim* " me Qendrën Shëndetësore Lunik, Nr. 8029 Prot , datë 04.12.2025 "*kërkesë për bashkëpunim* " me Qendrën Shëndetësore Polis, Nr. 8031 Prot , datë 04.12.2025 "*kërkesë për bashkëpunim*" OSHEE, Nr. 8032 Prot , datë 04.12.2025 "kërkesë për bashkëpunim " Ujësjellës Kanalizime, Nr. 8033 Prot , datë 04.12.2025 "kërkesë për bashkëpunim "Komisariatit te Policisë , Nr. 7959 Prot , datë 27.11.2025 "kërkesë për bashkëpunim "Zyrës Arsimore Vendore Nr. 7919 Prot , datë 26.11.2025 "Dërgim informacioni për debitorët" Drejtorisë së Shërbimeve pranë Bashkisë Librazhd ,Nr. 7919 Prot , datë 26.11.2025 "Dërgim informacioni për debitorët" Drejtorisë së Buxhetit , menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Librazhd .

Gjithashtu janë njoftuar për pagesë debitorët familjare sipas listës me një Nr. 65 abonentë me vlerën debitorë 1,036,161 lekë me shkresë Nr. 8114 Prot , datë10.12.2025. Nr. 1084 Prot ,datë 25.02.2025 " Kërkesë për bashkëpunim" të gjithë drejtorive pranë Bashkisë Librazhd . Në zbatim të urdhrit të titullarit Nr. .975 , datë 22.10.2025 " për te verifikuar në vend subjektet debitorë, janë mbajtur konstatime dhe janë arkëtuar një numër prej 10 subjekteve në vlerën 240,590 lekë. Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se niveli i debitorëve nga viti 2024 në 2025, paraqitet në ulje për vlerën 673,408 lekë, por përsëri pavarësisht masave të marra mbetet akoma dhe shumë punë për të bërë, pas nga të dhënat konstatohet se niveli i detyrimeve debitorë është gati 50% e planit të të ardhurave, e cila nëse do mund të ishin arkëtuar do kishim një rritje të nivelit të të ardhurave e cila do ndikojnë në realizimin e projekteve të bashkisë. Gjithashtu evidentohet dhe fakti se një pjesë e debitorëve, pavarësisht se ju ngarkohen detyrimet vit pas viti mbeten përsëri debitorë.

- Analiza e taksës së tokës bujqësore si më poshtë: për vitin 2025

Nr.	Njësitë Administrative	Tokë bujqësore gjithsej ha në 01/08/1991	Numri I familjeve që kanë marrë AMTP	Sipërfaqja e tokëse ndarë në faktigji nr.7501	Kategoria e tokës e ndarë sipas Ligjit nr.7501/në hektar							Totali i kategorive	Sipërfaqja e tokë së pandarë
					I	II	II	IV	V	VI	VII		
1	Hotolisht	1,465	1,175	909	-	-	-	-	900	-	9	**2**	**556**
2	Qënder	3,028	1,956	1,904	-	-	-	-	1,777	91	36	**3**	**1,124**
3	Lunik	1,249	1,100	725	-	-	-	-	332	234	159	**3**	**524**
4	Orenjë	1,710	1,627	1,050	-	-	-	-	694	-	356	**2**	**660**
5	Polis	950	883	621	-	-	-	-	422	-	199	**2**	**329**
6	Stëblevë	1,276	711	463	-	-	-	-	189	-	274	**2**	**813**
	Shuma	**9,678**	**7,452**	**5,672**	**-**	**-**	**-**	**-**	**4,314**	**325**	**1,033**	**3**	**4,006**
	Çmimi sipas VKB								**1,250**	**1,200**	**1,100**		

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

- Debitorët nga dhënie e tokave bujqësore me qira. Janë lidhur 3 kontrata si më poshte në tabelë.

Nr.	Nipt	Subjekti	Adminstratori	Aktiviteti	Vendndodhja	Kontrata	
						Nr.	Date
1	M....A	N..	M.SH	T/buqesore	Dorez	495	01.02.2022
2	G...M	R.R.	R.R.	T/buqesore	Hotolisht	904	15.02.2017
3	H...D	R.B.	R.B.	T/buqesore	Polis	7330	27.12.2016

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

Lista në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Data e lidhjes së kontratës	Sipërfaqa në m^2	Deri më 31.12.2024	Nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025	Totali Progresiv
1	M.SH.	01.02.2022	121,200	223,152	74,538	297,690
2	R.R.	15.02.2017	8,000	**0**	**0**	**-**
3	R.B.	27.12.2016	27,410	**0**	**0**	**-**
Totali				**223,152**	**74,538**	**297,690**

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

- Debitorët nga dhënie e tokave bujqësore me qira

Në lekë

Njësia Administrative	Numri i kontratave	Sipërfaqa në m^2	Deri më datë 31.12.2025 detyrimi	Nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025	Totali progresiv
Njësia adminitrative Qender	1	121,200	297,690	74,538	297,690
Njësia adminitrative Hotolisht	1	8,000	-	-	-
Njësia adminitrative Polis	1	27,410	-	-	-
Totali	**3**	**156,610**	**297,690**	**74,538**	**297,690**

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

- Kontratat për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve për vitin 2025. Kontrata te lidhura me bashkinë për shfrytëzim te garazhdeve për vitin 2025.

Nr.	Subjekti		Emri i pronës adresa	Zona kadastrale	Numri pasurie	Pronësia
1	G.	Rr.	Garazhd	2446	9/17-N4	B. Librazhd
2	F.	L.	Garazhd	2446	9/17-N4	B. Librazhd
3	B.	C.	Garazhd	2446	9/17-N4	B. Librazhd
4	E.	Gj.	Garazhd	2446	9/17-N4	B. Librazhd
5	I.	H.	Garazhd	2446	9/17-N4	B. Librazhd
6	E.	R.	Garazhd	2446	9/17-N4	B. Librazhd
7	D.	Zh.	Garazhd	2446	9/17-N4	B. Librazhd
8	L.	F.	Garazhd	2446	9/17-N4	B. Librazhd

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

Nr.	Subjekti		Nipti/ID	Afati	Viti i lidhjes së kontratës	Sipërfaqe në m^2	Vlera në vit	Vlera e likuiduar	Detyrimet e pa likuiduara
1	G.	Rr.	G...H	1 vit	01.09.2025	14	16,800	16,800	0
2	F.	L.	H...3D	1 vit	01.09.2025	16.2	19,440	19,440	0
3	B.	C.	H...A	1 vit	01.09.2025	27.6	33,120	33,120	0
4	E.	Gj.	J20...22J	1 vit	01.09.2025	14.5	17,400	17,400	0
5	I.	H.	G7...S	1 vit	01.09.2025	15.6	18,708	18,708	0
6	E.	R.	I10...59U	1 vit	01.09.2025	22.5	27,000	27,000	0
7	D.	Zh.	H30...69Q	1 vit	01.09.2025	20.5	24,600	24,600	0
8	L.	F.	G41...09F	1 vit	01.09.2025	20	24,000	24,000	0
Totali						**150.9**	**181,068**	**181,068**	**0**

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

- ***Paraqitja e numrit të bizneseve për vitin 2025***

Për sa i përket numrit të subjekteve/bizneseve nga të dhënat e paraqitura rezultoi se për periudhën 2024 dhe 2025 subjektet që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në tabelën si më poshtë;

Lloji i Biznesit	Paraqitja e numrit te bizneseve			
	Gjendja me 31.12.2024	Biznese të reja viti 2025	Biznese të mbyllura/pezulluara viti 2025	Gjendja më 31.12.2025
Subjektet e Biznesit të Vogël	661	44	23	682
Subjekte e Biznesit të Madh	149	8	11	146
Subjekte Institucione	36	3	0	39
Gjithsej	**846**	**55**	**34**	**867**

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

- Shkresa e ardhur nga QKB (nr./datë/subjekti/statusi) dhe përgjigje e dhënë nga DTTV. Për vitin 2025

Nr.	Subjekti	Inspektor	Datë shkrese QKB	Nr.Prot Bashkia	Mbyllur/Pezullim /Riaktivizim	Janar-Dhjetor 2025
1	P.A.	E.F.	1285/ 21.01.2025	448/ 24.01.2025	Pezulluar	20.01.2025
2	H.K.	E.F.	2160/ 31.01.2025	737/06.02.2025	Pezulluar	17.01.2025
3	SH.M.	E.F.	716/14.01.2025	266/16.01.2025	Pezulluar	24.12.2024
4	L.GJ	E.F.	11426/02.06.2025	3925/04.06.2025	Pezulluar	29.08.2025
5	F.GJ	E.F.	412/09.01.2025	107/10.01.2025	Çregjistruar	12.06.2025
6	G.D.	E.F.	3858/30.12.2025	8576/31.12.2025	Çregjistruar	16.02.2026
7	J.A.	E.F.	1759/02.02.2026	742/05.02.2026	Çregjistruar	10.12.2025
8	H.A	E.F.	18731/08.10.2025	69145/09.10.2025	Çregjistruar	12.11.2025
9	F.S.	E.F.	14249/11.07.2025	4911/17.07.2025	Çregjistruar	22.08.2025
10	F.N.	E.F.	17407/15.09.2025	6354/18.09.2025	Çregjistruar	11.09.2025
11	H.K.	E.F.	1269/21.01.2025	447/24.01.2025	Çregjistruar	10.03.2025
12	SH.M.	E.F.	19345/17.10.2025	7244/24.2025	Çregjistruar	16.10.2025
13	P.G.	E.F.	234/07.01.2025	110/10.01.2025	Çregjistruar	28.12.2024
14	F.D.	E.F.	419/09.01.2025	109/10.01.2025	Çregjistruar	26.02.2025
15	E.L.	E.F.	959/07.11.2025	7633/12.11.2025	Çregjistruar	04.11.2025

Nr.	Subjekti	Inspektor	Datë shkrese QKB	Nr.Prot Bashkia	Mbyllur/Pezullim /Riaktivizim	Janar-Dhjetor 2025
16	XH.ZH.	E.F.	17177/10.09.2025	6115/11.09.2025	Çregjistruar	21.10.2025
17	R.S.	E.F.	5799/20.03.2025	1643/21.03.2025	Çregjistruar	17.09.2025
18	M.M.	E.F.	20739/24.12.2025	34/07.01.2025	Çregjistruar	10.02.2025
19	D.Q.	E.F.	326/08.01.2025	108/10.01.2025	Çregjistruar	30.12.2024
20	B.ZH.	E.F.	11481/03.06.2025	3924/04.06.2025	Çregjistruar	30.05.2025

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

- *Regjistri i subjekteve me mbyllje për vitin 2025*.

Nr.	Subjekti	Lloji Aktivitetit	Data e mbylljes	Akt-Verifikimi Nr., Datë	Grupi Kontrollit
1	E.GJ,	Bar - Kafe	12.06.2025	27.03.2025	E. Faqolli, G. Hoxha
2	G.T.	Tran/ Udhëtaresh	16.02.2026	12.01.2026	E. Faqolli, A. Tola
3	J.A.	Lojra Argëtuese	10.12.2025	20.01.2026	E. Faqolli, A. Tola
4	H.A.	Byrektore	12.11.2025	14.10.2025	E. Faqolli, G. Hoxha
5	F.S.	Konfeksione	22.08.2025	22.07.2025	E.Faqolli, A.Tola G.Hoxha
6	F.N.	Bar-Bilardo	11.09.2025	24.09.2025	E.Faqolli, A.Tola G.Hoxha
7	H.K.	Pjekje Kafe	10.03.2025	28.01.2025	E.Faqolli, A.Tola G.Hoxha
8	SH.M.	Ushqimore	16.10.2025	29.10.2025	E.Faqolli, A.Tola G.Hoxha
9	P.G.	Bar-Restorant	28.12.2024	14.01.2025	E.Faqolli, A.Tola G.Hoxha
10	F.D.	Bar-Kafe	26.02.2025	20.01.2025	E.Faqolli, A.Tola G.Hoxha
11	E.L.	Bujqësi	04.11.2025	26.05.2026	E.Faqolli, A.Tola G.Hoxha
12	XH.ZH.	Restorant	21.10.2025	16.09.2025	E.Faqolli A.Tola G.Hoxha
13	R.S.	Butik	17.09.2025	25.03.2025	E.Faqolli A.Tola G.Hoxha
14	M.M.	Pjese Këmbimi	10.02.2025	13.01.2025	E.Faqolli A.Tola G.Hoxha
15	D.Q.	Bar-Kafe	30.12.2024	21.01.2025	E.Faqolli A.Tola G.Hoxha
16	B.ZH.	Bar-Restorant	30.05.2025	10.06.2025	E.Faqolli A.Tola G.Hoxha

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimi

- ***Taksa e ndikimit në infrastrukturë***.

Nga të dhënat e marra, rezultoi se detyrimet mbi TNI e ndërtimeve informale deri me datë 31.12.2024 është për 177 praktika me vlerë 8,377 mijë lekë. Janë krijuar gjatë vitit 2025 për 114 praktika me vlerë 4,429 mijë lekë, likuiduar gjatë vitit 2025 për 91 praktika me vlerë 3,873 mijë lekë dhe gjendja progresive në fund të periudhës 2025, mbetet për 200 praktika me vlerë 8,933 mijë lekë, tabela si vijon:

Nr.	Gjendja me 31.12.2024		Dosje të hyra Janar – Dhjetor 2025		Pagesa të kryera Janar – Dhjetor 2025		Gjendje me 31.12.2025 Subjekte debitorë	
	Nr. dosje	Vlera /000	Nr. dosje	Vlera /000	Nr. dosje	Vlera /000	Nr. dosje	Vlera /000
1	177	8,377	114	4,429	91	3,873	200	8,933

- *Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre*.

Nr.	Subjekti	Adresa	Autorizime fillon-mbaron	*Niveli tarifës sipas VKM nr. 344*	Pagesë deri në vitin 31.12.2025	Pagesë gjatë vitit 2025	Detyrime për t'u paguar për autorizimin
1	S.	Rruga nacionale Librazhd-Elbasan	01.06.2023-01.06.2028	1,000,000	1,000,000	-	-
2	K.	Axhensia	10.11.2023-10.11.2028	1,000,000	1,000,000	-	-
3	S.	Rruga nacionale Librazhd-Prrenjas	04.04.2024-04.04.2029	1,000,000	1,000,000	-	-

4	M...	Unaza e Korçës	03.04.2024-.03.04.2029	1,000,000	400,000	400,000	600,000
5	H...	Rruga nacionale Elbasan-Librazhd	03.09.2024-03.09.2025	200,000	200,000	-	-
6	D.M.	Zgosht	20.06.2025-19.06.2030	1,000,000	1,000,000	1,000,000	-
7	H...	Rruga Hotolisht-Prrenjas	06.07.2022-06.07.2027	1,000,000	500,000	500,000	-

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se në territorin e Bashkisë Librazhd operojnë gjithsej 7 shoqëri me aktivitet tregtim hidrokarburesh, ku në total deri në fund të 2025 nuk kanë likuiduar detyrimet 1(një) shoqëri për vlerën 600,000 lekë, si mungesë të ardhurash (shoqëritë sipas pasqyrës).

- Të ardhurat dhe detyrimet nga asetet e fondit pyjor kullosor janë sipas *aneksit 2.2.5.2, b/lidhur RPA*. Nga të dhënat, konstatohet se në territorin e Bashkisë Librazhd janë lidhur gjithsej 90 kontrata qiraje me veprimtari të ndryshme afat nga 1 deri ne 10 vite. Detyrimi vjetor është për vlerën 17,833,927 lekë. Janë debitorë nga viti 2024 vlera prej 4,438,493 lekë, kanë likuiduar gjatë vitit 2025 vlera prej 17,921,455 lekë, duke mbetur për likuidim vlera prej **4,350,965 lekë më 31.12.2025, si mungesë të ardhurash.**
Për sa trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi*; L.SH. Drejtori i të Ardhurave Vendore. E.P. Përgjegjësi e Sektori i Planifikimit te te Ardhurave Vendore dhe M.G. Përgjegjës Sektori i Mbledhjes se te Ardhurave Vendore.*

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktive neto dhe fluksit të parasë bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimit të MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", është përpunuar informacionin kontabël i vitit 2025.
Pasqyrat Financiare Bashkia Librazhd janë përgatitur nga A.H.. me detyrë Drejtore e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Mbështetëse (*Nëpunësit Zbatues)*, A.A. me detyrë Përgjegjës i Financës, dhe janë konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë, M.D. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë (*Nëpunësit Autorizues)*, të cilat janë depozituar me shkresën nr. 1221 Prot, datë 25.02.2026, konfirmuar nga Dega e Thesarit me nr. 66 Prot, datë 27.02.2026 (*faqe 6 e pasqyrave financiare*).

- ***Nxjerrja e pasqyrave financiare, për vitin 2025 (Bashkia Librazhd)***.

Për vitin 2025, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, janë përgatitur pasqyrat financiare të Bashkisë Librazhd, pasi pasqyrat e konsoliduar akoma nuk ishin mbyllur plotësisht, të përbëra si vijon:
Format nr. 1 – *Pasqyra e pozicionit financiar*.

Format nr. 2 – *Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).*
Format nr. 3 – *Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).*
Format nr. 4 – *Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto*.
Format nr. 5 – *Pyetësor dhe shënimet shpjeguese*.
Format nr. 6 – *Investimet dhe burimet e financimit*.
Format nr. 7/a – *Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).*
Format nr. 7/b – *Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).*
Format nr. 8 – *Numri i punonjësve dhe fondi i pagave*.

- ***Mbajtja e kontabilitetit Viti 2025*.**

Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2025 janë bërë duke kryer paraprakisht manualisht regjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të gjitha veprimeve financiare të realizuara gjatë secilit vit ushtrimor; kontabiliteti mbahet në regjistra manual dhe pjesërisht në programin Microsoft Excel.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me trequesit e realizimit të buxhetit***:

Nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës, sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë të ekstrakteve të bankës (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total, mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditar i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit*.**

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël ishin kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- mbështetjen në dokumente justifikuese, të vërtetuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike, deri në mbyllje të ushtrimit të mëparshëm;
Nëse informacioni kontabël mundëson në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazim i lëvizjes së ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Bashkisë Librazhd*.**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
- Kontabiliteti në përgjithësi është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e informacionit bazë dhe justifikues, duke përjashtuar disa prej llogarive të cilat gjejnë pasqyrim më poshtë;
- Në këtë njësi publike, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale dhe më pak informatike në programin "Microsoft Excel";
- Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre ishin kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur libri i madh apo

libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, aktmarrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si: faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- ***Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar, Pohimet mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare*.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të njësisë për aktivitetin ekonomiko –financiar të vitit 2025, pasi pasqyrat e konsoliduar deri në datën e këtij akti nuk ishin hartuar me gjithë njësinë vartëse Ndërmarrja e Punëve Publike, ngritur në shkurt 2025. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatuan se në përgjithësi janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje dhe në mbyllje për vitin 2025.

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2025, të pasqyrës të pozicionit financiar Bashkia Librazhd; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 1,327,233,184 lekë.

Aktivet 1,618,554,588 lekë
Pasivet 291,321,404 lekë.

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën **478,643,204 lekë** dhe përbëhen nga:
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 201,028,354 lekë,
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 59,728,129 lekë,
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 217,886,721 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 "*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
520	Disponibilitete në thesar	200,917,726	222,343,352	(21,425,626)
532	Vlera të tjera	110,628	119,268	(8,640)
	Totali	**201,028,354**	**222,462,620**	**(21,434,266)**

Gjendja e *"Mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre",* analizon mjetet monetare (në arkë dhe bankë), si dhe ekuivalentët e tyre (*si letra me vlerë, disponibilitete në thesar etj*.). Në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 201,028,354 lekë, me ulje nga viti paraardhës në vlerën 21,434,266 lekë.

Llogaria 520 "*Disponibiltete në thesar*" në vlerën 200,917,726 lekë, përbëhet:
-Nga të ardhurat e trashëguara në vlerën 127,483,052 lekë, të rakorduara me Degën e Thesarit dhe për gjendjen e llogarisë 466 "*Mjete në ruajtje*" në vlerën 73,434,674 lekë për vlerën e ngurtësimeve të punimeve të kryera në masën prej 5% të investimeve në proces (*në rrugë, rrjete e kanalizime, ndërtesa shkollore*), etj.
- Llogaria 532 *"Vlera të tjera"*, në vlerën prej 110,628 lekë e cila përfaqëson bileta tregu në vlerën 3,540 lekë dhe blloqe arkëtimi në vlerën 107,088 lekë, sipas procesverbaleve të mbajtura me datë 31.12.205 me përgjegjësit materiale.
Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e "*Mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre*", e pasqyruar në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 në vlerën 201,028,354 lekë rakordojnë me rubrikën VI "*Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor*" në Formatin nr.3 "*Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte*". *Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.*
Llogaritë e Klasës 3 "*Gjendje inventari qarkullues*", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
31	Materiale	6,258,106	27,479,272	(21,221,168)
32	Inventar i imët	53,470,023	56,704,438	(3,234,415)
	Totali	**59,728,129**	**84,183,710**	**(24,455,583)**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Librazhd në datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 59,728,129 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 "*Materiale*" në vlerën 6,258,106 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "*Inventar i imët*" në vlerën 53,470,023 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën 24,455,583 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "*Ndryshimi gjendjes së inventarit*" në shumën 24,455,583 lekë.
Llogaria 312 "*Materiale*", ka vlerën 6,258,106 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen e inventarizimit e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	**27,479,272**
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025 (D)	28,011,827
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025(K)	31,771,801
Transferim 2025	17,461,192
Gjendja në 31.12.2025	**6,258,106**

Sipas të dhënave të raportit përmbledhës të inventarizimit, paraqitet në *Aneksin 2.3.1, b/lidhur RPA.*
Llogaria 32 "*Inventarë i imët*", ka vlerën 53,470,023 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen e inventarizimit e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	**56,704,438**
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025 (D)	2,538,654
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025(K)	3,971,417
Transferim 2025	1,801,652

Gjendja në 31.12.2025	**53,470,023**

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

- **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2025 Bashkia Librazhd.**

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit ishte kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve/ shtesat/ pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në tabelën nr. 7/a, "*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)*", tabelën nr. 7/b, "*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)*", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-daljet nga magazina etj.,.

Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit për vitin 2025, ka dalë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë, për ngritjen e komisionit të inventarizimit, siç tregohet në *Aneksin 2.3.2, b/lidhur RPA.*

Në përfundim të inventarizimit, nga komisionet nuk janë konstatuar diferenca në vlerë/copë midis kontabël dhe fizikut. Sipas këtij komisioni në përfundim është arritur në Konstatimin se disa nga artikujt e kanë humbur funksionin e tyre dhe janë të papërdorshëm, për të cilën janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimit, si vijon:

Nga Viti 2024/propozuar asgjësim	Nr.	Vlera /lekë
Llog.214	8	552,319
Llog. 327	8	3,971,417
Llog. 218	8	6,093,148
Llog. 312	0	0
Llog. 218/6	0	0
Totali	**24**	**10,616,884**

***Burimi**: Bashkia Librazhd*

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit **nuk ishte hartuar raporti për inventarin fizik**, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 85, germa "c"[4].

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Librazhd nr. 344, datë 17.04.2025 (*Prot 2130, janë ngritur komisionet për asgjësimin tjetërsimin e aktiveve në pronësi të bashkisë Librazhd të nxjerra jashtë përdorimit, kjo referuar VKB nr. 33, datë 28.3.2025 (konfirmim të aktit nr. 456/1 Prot, datë 9.4.2025*), me përbërje: *A.A., M.G., M.D., D.T., E.N.*.

Nga ana e komisioni pas verifikimit të materialeve për jashtë përdorimit është bërë asgjësimin e tyre sipas procesverbaleve:

[4] Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Komisionet e inventarizimit të aktiveve të institucionit të sipërpërmendura**.**

a- Procesverbali datë s'ka, me objekt asgjësimin dhe tjetërsimin e materialeve nga ana e komisionit që kanë dalë jashtë përdorimit me vendim nr. 104, datë 27.11.2024, dhe konfirmuar nga Prefekti Qarkut Elbasan me shkresë nr. 1305/1, datë 16.12.2024, të materialeve të çerdhen e qytetit; Kopshti ne. 1 dhe 2, Shkolla Ibrahim Muca, për llogaritë 214 në vlerën 239,473 lekë, llogarinë 218 për vlerën 2,677,781 lekë dhe llogarinë 327 për vlerën 2,373,938 lekë.
b- Procesverbali datë s'ka, me objekt asgjësimin dhe tjetërsimin e materialeve nga ana e komisionit që kanë dalë jashtë përdorimit me vendim nr. 104, datë 27.11.2024, dhe konfirmuar nga Prefekti Qarkut Elbasan me shkresë nr. 1305/1, datë 16.12.2024, të materialeve të MZSH, për llogaritë 214 në vlerën 77,140 lekë dhe llogarinë 327 për vlerën 990,310 lekë.
c- Procesverbali datë s'ka, me objekt asgjësimin dhe tjetërsimin e materialeve nga ana e komisionit që kanë dalë jashtë përdorimit me vendim nr. 104, datë 27.11.2024, dhe konfirmuar nga Prefekti Qarkut Elbasan me shkresë nr. 1305/1, datë 16.12.2024, të materialeve të njësive administrative Polis, Hotolisht, Shkolla 9-vjerave Genc Leka, për llogarinë 218 për vlerën 3,415,367 lekë dhe llogarinë 327 për vlerën 1,609,129 lekë dhe llogaritë 214 në vlerën 301,196 lekë
Në procesverbalet e asgjësimit të aktiveve citohet se, "...*Materialet prej hekuri do të shkojnë për skrap pasi të peshohen, bëhen hyrje dhe të shiten me çmimin e tregut. Ndërsa të tjerat do të digjen*".
Nga auditimi i procedurës së inventarizimit të aktiveve, ***u konstatua se:***
- Komisioni i inventarizimit fizik *nuk ka hartuar* Relacionin përmbledhës mbi procedurën e inventarizimit fizik, në mos përmbushje të Udhëzimin e MF nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, Kreu IV, pika 85/c. *Mungesa e Relacionit përmbledhës* përbën dokumentim jo të plotë të procedurës së inventarizimit, pasi mungojnë: analiza përshkruese që shpjegon rezultatet, veprimet e propozuara dhe interpretimi i informacionit të tabelave. Kjo sjell vështirësi në të kuptuarit e situatës reale të aktiveve.
- Sektori i Financës në Bashkinë Librazhd, *nuk ka krijuar* një regjistër aktivesh sipas kërkesa ligjore, në moszbatim të Udhëzimit e MF nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, Kreu III, pika 26,27,28,29,30 dhe 31;
- Sektori i Financës në Bashkinë Librazhd *nuk ka miratuar* regjistrin e unifikuar të aktiveve, në mos përmbushje të Udhëzimin e MF nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, Kreu III, pika 26,27,28 etj. Mungesa e një regjistri të unifikuar bën që Njësia publike të mos ketë një pasqyrë të saktë dhe të konsoliduar të aktiveve, duke riskuar përdorimin jo efektiv të tyre apo të dhëna jo të sakta e të plota në pasqyrat financiare.
- Në praktikën dokumentare të përpiluar nga komisioni i inventarizimit fizik dhe vlerësimit paraprak, rezultoi se lista e aktiveve të vlerësuara të dëmtuara nuk përmban informacion të plotë si vitin e hyrjes së aktivit, koha e përdorimit, shpenzimet për mirëmbajtje etj., në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar, kreu III pika 30, kreu IV pika 85/b dhe 95.
- Anëtarët e komisionit për "*vlerësimin e aktiveve të cilësuara të dëmtuara nga komisioni i inventarizimit fizik dhe vlerësimit paraprak*" referuar përmbajtjes së Urdhrit të Titullarit dhe listës së aktiveve të cilësuara paraprakisht të dëmtuara, *rezultoi se* nuk është në përputhje me kërkesat ligjore dhe konkretisht: Kryetari i komisionit të vlerësimit nuk është caktuar NZ si dhe anëtarët nuk disponojnë ekspertizën e nevojshme teknike në fushën përkatëse të këtyre aktiveve, në mospërputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar kreu IV pikat 99, 102, 103 dhe 104.
Mosrespektimi i kritereve për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe mungesa e ekspertizës teknike përkatëse sjell:
- Rrezik për vlerësim jo të saktë dhe jo të plotë të aktiveve të dëmtuara;
- Vendimmarrje të pabazuar në analiza profesionale;

- Mundësi për dëm ekonomik ndaj buxhetit të institucionit si pasojë e nënvlerësimit apo mbivlerësimit të aktiveve të dëmtuara.
- Aktivet e vlerësuara të dëmtuara për jashtë përdorimit, për të cilat nevojitet ekspertizë teknike si në pasqyrën 1 dhe 2, si më poshtë:

Pasqyra nr. 1.

Bashkia Librazhd/ Shkolla Genci Lela				
Nr.	**Emërtimi**	**Sasia**	**çmimi**	**Vlera /në lekë**
1	Kompjuter 31.12.2021	1	93,000	93,000
2	Magnetofon	1	9,300	9,300
3	Pronter zeroks	1	25,000	25,000
4	Bateri kompjuteri	1	5,367	5,367
5	Video projektor	1	64,570	64,570
6	DVR (264/2019)	1	22,320	22,320
7	Fonia komplet	1	100,000	100,000
8	Skaner	1	25,000	25,000
9	Printer	1	14,600	14,600
10	Kompjuteri komplet	1	44,339	44,339
	Totali	**10**		**403,496**

***Burimi**: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit*

Pasqyra nr. 2

Bashkia Librazhd/ Shkolla e mesme Polis				
Nr.	**Emërtimi**	**Sasia**	**çmimi**	**Vlera /në lekë**
1	kompjuterë 2013	4	50,000	200,000
2	kompjuter nxënësish	4	43,331	173,324
3	Kompjuter mësuesish	1	49,371	49,371
4	Printer	1	14,601	14,601
5	Skaner	1	4,724	4,724
6	Rot-7D 2015	1	5,367	5,367
7	Kompjuter	1	70,000	70,000
8	Printer xerox	1	25,000	25,000
9	Skaner reuter	1	47,000	47,000
10	printer	1	25,000	25,000
	Totali	**16**		**614,387**

Vlerësimi i aktiveve të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Udhëzimin e MF nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar.
- Bashkia Librazhd, GMS dhe GMR nuk kanë hartuar dhe miratuar: Rregullore për menaxhimin e aktiveve të njësisë, Gjurmët përkatëse të auditimit, Menaxhimin e riskut dhe strategjinë e menaxhimit të riskut (për aktivet), në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar dhe Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar, kreu I pikat 6,7,8,9,16, 18; kreu II, pika 17-25 ; kreu V.
- Bashkia Librazhd në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve ka hartuar, por nuk e ka regjistruar në librin e Protokollit të Bashkisë regjistrin e aktiveve materiale të njësisë për vitin 2025, në moszbatim të "Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë" kreu II/A, neni 19 pika 1.

Nga auditimi ka rezultuar se ishin kryer inventarë fizik për llogarinë 32 "*Inventarë i imët*", llogarinë 214 " *Instalime teknike Makineri pajisje*" dhe llogarinë 218 "*Inventarë ekonomik*" ndërsa për llogaritë e tjera të Aktiveve Afatgjata Materiale nuk ishte kryer inventarë fizik, si rrjedhojë pasqyrat financiare përmbajnë vetëm vlerat kontabël të tyre, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket llogarive në fund të vitit, veprime në shkelje të kërkesave të Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat; 74, 77, 83, 85/a, b, 86, 95, Udhëzimin e MF nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018

"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu III, pika 30.
Për sa më lart, veprimet apo mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore: Neni 8 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit",* si dhe nenet 9, 10, 11 të Ligjit nr.10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Manualit MFK i ndryshuar, kapitulli II, paragrafi 2.4; Udhëzimi nr. 21/2016 "Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve" ; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07,2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Udhëzimi e MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, ***për të cilën mbajnë përgjegjësi***:
M.D., me detyrë Kryetar i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e nëpunësit autorizues.
A.H., me detyrë Drejtore në Drejtorinë e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale, në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe komisionet e inventarizimit ngritur me urdhër Kryetarit të Bashkisë Librazhd nr. 925, datë 7.10.2025 (*Prot 6862*), nr. 926, datë 7.10.2025 (*Prot 6863*), si dhe komisionit të nxjerra jashtë përdorimit ngritur me urdhër nr. 344, datë 17.04.2025 (*Prot 2130*.
Llogaritë e Klasës 4 "*Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra*", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme	**17,886,721**	**18,576,661**	**(689,940)**
468	Debitorë te ndryshëm	30,720,206	28,754,710	1,965,496
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	87,166,515	89,821,951	(2,655,436)

Llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 128,754,710 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 130,720,206 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur rritje 121,358,143 lekë, dhe pakësuar për vlerën 119,392,647 lekë, sipas *Aneksit 2.3.8 b/Lidhur RPA*.
Kontabilizuar si detyrimeve për vlerën 130,720,206 lekë, sipas informacioneve të marra nga Drejtoria e Taksave, IMTV, policia bashkiake etj, por jo me emra debitorësh, pasi emrat janë të pasqyruara në drejtoritë përkatëse që i administron ato, dërguar me shkresat respektive si:

- *Me shkresën nr. 317 Prot, datë 19.01.2026, nga drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqësor dhe Turizmit, informacion mbi blloqet e vërtetimeve të transportit për 170 copë;*
- *Me shkresën nr. 580Prot, datë 29.01.2025 nga IMTV për detyrimet në vlerën 1,000,000 lekë, me emra debitorësh;*
- *Procesverbal datë 31.12.2025 me përgjegjësin e tregut;*
- *Me shkresën nr. 834 Prot, datë 10.2.2016 nga drejtoria e të Ardhurave Vendore (në total);*

Llogaria 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)*", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 87,166,515 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa, sigurime shoqërore dhe fatura të palikujduara në fund të periudhës dhe kuadron me Llogarinë 7206 "*Financim i pritshëm nga buxheti*" të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 87,166,515 lekë.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)
Llogaritë e Klasës 20 "*Aktivet Afatgjata Jo materiale*", përbëhen nga llog. 202 "*Studime dhe kërkime*", në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 23,781,694 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" gjendja paraqitet si në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 46,341,008 lekë (viti 2024: 44,361,386 lekë).

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, në tabelën *Aneks nr. 2.3.3, bashkëlidhur*.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se janë bërë shtesa në vlerën 1,979,620 lekë të cilat konsistojnë në kapitalizmin e aktiveve afatgjata jomateriale kryesisht:

- *Për projektin "Hartim projekti i Studim Oponenca teknike Rikonstruksion i rrugës Marinaj –Kuturman Nj.Ad Qendër" të cilat janë likuiduar sipas kontratës nr. 2385 datë 05.05.2025, me vlerë 943,136 lekë, me Urdhër shpenzimi nr. 912 datë 19.11.2025 vlera 943,136 lekë për faturën nr. 21/2025. datë 29.10.2025;*
- *Projekti me objekt dhe projekti "Studim projektim oponencë teknike për objektin Ndërtim i Poliklinikës së re në qytetin e Librazhdit", të cilat janë likuiduar sipas kontratës nr. 6295 datë 19.12.2024, me vlerë 1,036,484 lekë, me Urdhër shpenzimi nr. 695 datë 10.9.2025 për faturën nr. 9/2025. datë 4.9.2025.*

Konstatimi 1: Nga auditimi, konstatohet se llogaria 202 "*Studime dhe projektime*" në formatin Nr. 7/a paraqiten me koston historike në vlerën 46,341,008 lekë, e analizuar për 46 objekte inventari, Nga verifikimi i inventarit kontabël u konstatua se 34 projekteve me vlerë 32,361,069 lekë, të cilat i përkasin periudhave të hershme (2011 -2023), për të cilat nuk ka informacion nëse ato janë vënë në zbatim për tu sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e AAM, të numrit të tyre për efekt të inventarizimit fizik dhe llogaritjes së amortizimit, veprim në mospërputhje me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)
Llogari 210 "*Toka, troje Terrene*", sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, paraqiten në vlerën 11,802,993 lekë (viti 2024: 18,475,912 lekë), pakësuar për vlerën 6,672,919 lekë nga transferime të brendshme. Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, në tabelën *Aneks nr. 2.3.7, bashkëlidhur*.
Llogaria 211 "*Pyje, kullota Plantacione*", sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 0 lekë (viti 2024: 0 lekë).
Llogaria 212 "*Ndërtesa konstruksione*", në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 778,797,682 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,127,763,497 lekë (viti 2024: 946,072,285 lekë). Gjatë vitit 2025 kjo llogari ka shtesa për blerje me pagesë në vlerën **199,079,631 lekë,** të kontabilizuara me dokumentacion për objektet, sic tregohet në *Aneksin 2.3.4, b/lidhur RPA.*
Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, në tabelën *Aneks nr. 2.3.5, b/lidhur RPA.*
Sipas informacionit të marra nga Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Procedurave të prokurimit, totali i kontratave për investime për vitin 2025, paraqitet në shumën 563,479,836 lekë, nga e cila planifikuar për likuidim në vitin 2025 në vlerën 515,116,479 lekë, të dhëna të cilat paraqiten në Aneksin 2.3.6, b/lidhur RPA.

Konstatimi 2: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" në mbyllje të vitit 2025, llogaria 212 "*Ndërtime konstruksione*" paraqitet në vlerën 1,127,763,497 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se për 36 objekte me vlerë të mbetur 270,428,882 lekë, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo

aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM-së , por janë trajtuar si aktive më vete, gjithashtu nuk jep informacion se sa nga asetet e transferuara me VKM me listë përfundimtarë janë të regjistruara në kontabilitet, amortizimi nuk është llogaritur për çdo artikull por në grup, në këtë llogari ka vlera të paanalizuara me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerat neto dhe inventarin fizik, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa b), sipas *Aneksit 3.4 bashkëlidhur materialit*.

Konstatimi 3: Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Tabelën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet *"vlerën reale"* të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Librazhd, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 "*Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale*", Paragrafi "Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale", pika 23-32 "*Modeli i rivlerësimit*". Vlera fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarëve kontabël të llogarisë 212 "*Ndërtesa dhe konstruksione*" janë 7 objekte nga vlera 5,101 lekë deri ne vlerën 92,292 lekë (tabela 1), dhe për llogarinë 215 "*Mjete transporti*" janë 6 mjete nga vlera 5,676 lekë deri ne vlerën 91,572 lekë (tabela 2). Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, pika 105 "*Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar*".

Pasqyra nr. 3: *Për llogarisë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione".*

I.	**BASHKIA LIBRAZHD**	**VITIT**	**Vlera e mbetur me 31.12.2025**
1.	Rikonstruksion i kopshtit Nr. 2	2017	13,751
2.	Kolaod. Izolim i soletës Vilson Blloshmi	06.10.022	16,252
3.	Rik. ambulanca ura e Spatharit	2007	92,292
4.	Rrjeti elektrik shkolla Dragostunje	2016	62,892
5.	Mbikëqyrje Ndërtim I këndit sportiv ne shkollën e mesme te bashkuar Orenje	2023	-
6.	Kolaudo nd. shkolla 9-vjecare vartëse Sebisht .	06.10.2022	5,101
7.	Kolaudim rikonstruksion I pallatit kulturës.	18.03.022	59,416

Pasqyra nr. 4: *Për llogarinë 215 "Mjete transporti".*

Nr.	**PERSHKRIMI**	**VITIT**	**Vlera neto me 31.12.2025**
1.	Ambulance Reno	cope	91,572
2.	Automjet Tip Kamion Magirus	cope	62,953
3.	Nisan TR4036B	04.01.024	81,600
4.	Autoveture (Fuoristrade) AA880IV	cope	59,908
5.	Makine transporti benz		5,676
6.	Makine ALL-73 SH003778	2013	58,989

Llogaria 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 263,290,404 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 687,363,916 lekë (viti 2024: 3,715,076,090 lekë). Gjatë vitit 2025 kjo llogari ka shtesa për blerje me pagesë në vlerën **210,661,245 lekë,** të kontabiluara me dokumentacion për objektet, siç paraqitet në *Aneksin 2.3.7, b/lidhur RPA.*
Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, në tabelën *Aneks nr. 2.3.8, b/lidhur RPA.*

Konstatimi 4: Llogaria 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 687,363,916 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se, nuk është zbritur vlera për 8 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në shumën 78,700,102 lekë që duheshin transferuar UK Elbasan, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85**,** Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 24 dhe 30, sipas tabelës si vijon:

Nr.	EMËRTIMI	VITI	Historiku 31.12.2025
1.	Kolektor I Ujërave te zeza Ish- NB dhe Sharre	2012	12,455,236
2.	Mbik. Furn. ujë fshatrat gizavesh dorez	15.09.2022	479,206
3.	Kanali Tjerë (KU Neshte Librazhd) Transferuar nga Bordi I Kullimit	1979	193,005
4.	Ku Mirake ,KU St.Mirake (Bordi I Kullimit)	1977	2,947
5.	Ndërtim ujësjellës Polis gostim	27.07.022	9,500,000
6.	Ndërtim ujësjellësi Polis -Gostime	18.04.2023	49,223,163
7.	Ndërtim KUZ dhe KUB ne qendër te Komunës Stebleve	2006	4,649,645
8.	Ndërtim KUZ dhe KUB ne lagjen e Tupajve dhe Postbllokut ne fshatin Llange dhe blerje tubash	2007	2,196,900

Burimi: *Hartuar nga grupi auditimit*

Llogaria 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*", në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 17,550,113 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 44,465,816 lekë (viti 2024: 45,461,550 lekë).
Gjatë vitit 2025 kjo llogari ka shtesa për blerje me pagesë në vlerën **1,370,600 lekë,** të kontabiluara me dokumentacion për objektet si në tabelën si vijon:

Nr.	Objekti	Kontrata		Vlera	Likuidua Urdhër shpenzim		Vlera
		Nr.	date		Nr.	date	
	Dush për çerdhen						20,000
	Dush për kopshtin nr. 2						20,000
	Mikrofon + kamera gimbal						99,700
	Kompjuter + printer						3,311
	Kondicioner						65,300
	Lavatrice						59,000
	Materiale elektrike hidraulikë						12,400
	Motosharre						68,000
	Pajisje kompjuterike						548,000
	Kompjuter						99,800
	Frigorifer						59,000
	Kompjuter + printer zva						99,036
	Pajisje për mzsh						294,000
	Shërbime kamerash						23,400
	Frigorifer						1

Nr.	Objekti	Kontrata		Vlera	Likuidua Urdhër shpenzim		Vlera
		Nr.	date		Nr.	date	
	SHUMA						**1,370,600**

Burimi: *Hartuar nga subjekti, përpunuar nga grupi.*

Gjatë vitit 2025 kjo llogari ka shtesa nga jashtë sistemit në vlerën **2,791,159 lekë** *të kontabiluara me dokumentacion për objektet si në tabelën si vijon:*

Nr.	Objekti	Dhuruesi flet dalja		Vlera	Hyrje		Vlera
		Nr.	date		Nr.	date	
1	Kompjuter Dell	ZVA 45,46,47,48,49,50	16.12.2024	2622	38/3	04.04.2026	2622
2	Printer Brother	ZVA 45,46,47,48,49,50	16.12.2024	689.25	38/3	04.04.2026	689.25
3	Laptop	ZVA 103	23.11.2022	1,344,406	38/1	04.04.2025	1,344,406
4	Maus	ZVA 103/1	23.11.2022	1,344,406	38/1	04.04.2025	1,344,406
5	Destop kompjuter	ZVA 100	27.11.2025	99,036	124/1	02.12.2025	99,036
	SHUMA						**2,791,159**

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, dhe lëvizjet e për shtesa e paksime paraqitet në tabelën *Aneks nr. 3.5, bashkëlidhur materialit:*

Llogaria 215 "*Mjete transporti*", në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 14,425,222 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 45,924,094 lekë (viti 2024: 96,408,751 lekë).

Gjatë vitit 2025 kjo llogari ka shtesa për blerje me pagesë në vlerën **1,517,000 lekë** të kontabiluara me dokumentacion. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 kjo llogari ka shtesa nga jashtë sistemit në vlerën **6,895,000 lekë** *të kontabiluara me dokumentacion për objektet si më poshtë***:**

Nr.	Objekti	Kontrata		Vlera	Likuidua Urdhër shpenzim		Vlera
		Nr.	date		Nr.	date	
1	Blerje kamion zjarrfikës	311	20.01.2025	8,274,000	214	17.03.2025	2,482,200
					679	04.09.2025	5,791,800
2	Makina benz AB848JT amortizator						20,000
3	Bens 7 ton kryq transmisioni						8,000
4	Foristrad hynday AA224MD amortizator + kryq transmisioni						28,000
5	Toyota AB046FM amortizator						24,000
6	Toyota AB771BJ grup timoni						40,000
7	Toyota RAV 4 AB574LY amortizator						18,000
	SHUMA						**8,412,000**

Burimi: *Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit.*

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, dhe lëvizjet e për shtesa e paksime paraqitet në tabelën *Aneks nr. 2.3.9, b/lidhur RPA.*

Konstatimi 5: Nga të dhënat e paraqitura në tabelën aneks 7/a, rezultoi se vlera në çelje për kosto historike të llogarive (210; 212; 213; 2014 dhe 2015), nuk rakordojnë me analizën e çeljes së inventarit kontabël të këtyre llogarive, me ndikim në informacioni kontabël, ku pasqyrat statistikore 7/a për shtesa dhe pakësime të kontabilizuara gjatë vitit 2025 dhe vlerave në fund të periudhës, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimit të MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", pika 5 germa g), ku thuhet se: Për rastin e transferimit të fondeve për shpenzimet kapitale nga institucionet brenda sistemit (pra nga institucioni qendër në njësi vartëse dhe anasjelltas), ndiqet procedura e regjistrimit dhe funksionimit të llogarisë 8422 *"Transferimi i të ardhurave brenda sistemit".*

Llogaria kontabël 218 "*Inventar ekonomik*". Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"* në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 30,263,277 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 88,311,006 lekë (viti 2024: 86,827,432lekë).

Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 7,576,722 lekë si më poshtë:

Nr.	Objekti	Kontrata		Vlera	Likuidua Urdhër shpenzim		Vlera
		Nr.	date		Nr.	date	
1	Mobilje qendra rinore						1,380,720
2	Dhurate mobilje nga OTP						1
3	Mobilje shërbimi social për te gjithë						108,000
4	Ëhite board shërbimi social për te gjithë						30,000
5	Blerje mobilje						100,000
6	Blerje karrike administrata						49,800
7	Materiale shkolle Zyra						5,706,120
8	OPT						1
9	Blerje krevat						202,080
	SHUMA						**7,576,722**

Është pakësuar për vlerën 6,093,148 lekë nxjerrje jashtë përdorimit. Nga verifikimi i dokumentacionit mbi procedurën e nxjerrjesh për jashtë përdorimit, konstatohet se ai është në përputhje me kuadrin ligjorë dhe Udhëzimin nr. 30 të MF.

Llogaria 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 0 lekë.

Llogaria 231 "*AAGJM Investime në proces*" paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 0 lekë.

Konstatimi 6: Nga auditimi u konstatua se llogaria 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*" në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 0 lekë, në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se ka kontrata që nuk janë likuiduar pasi nuk kanë përfunduar si punime për llogarinë 212 "*Ndërtesa konstruksione*" për 3 objekte me vlerë kontrate 185,624,714 lekë të cilat janë likuiduar në fakt në vlerën 45,093,279 lekë, llogarinë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" për 7 objekte me vlerë kontrate 154,715,584 lekë të cilat janë likuiduar në fakt në vlerën 25,458,327 lekë, pra vlera e llogarie 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", është raportuar e nënvlerësuar për vlerën 70,551,606lekë, veprime në kundërshtim Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23, sipas tabelës 3 dhe 4 si vijon:

Tabela 3: Llogaria 212 "*Ndërtesa konstruksione*"

Nr.	Objekti Kontratës	Fituesi	Nr. Kontrate	Data	vlera e kontratës me TVSH	Likuiduar deri me 31.12. 2025
1	Rikonstruksion tërësor dhe rindërtim I palestrës se shkollës Vilson Blloshmi	Z.	5511	18.08.2025	102,531,959	41,669,796
2	Përmirësimi I banesave ekzistuese për komunitete te varfera dhe te pafavorizuara	H.	6591	26.09.2025	55,060,280	3,423,483
3	Ndërtim I parkut aventuresk (zip line ballkon panoramik observator astronomik)	A.	7180	22.10.2025	28,034,475	
	Shuma…..				**185,626,714**	**45,093,279**

Tabela 4: Llogaria 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*".

Nr.	Objekti Kontratës	Fituesi	Nr. Kontrate	Data	vlera e kontratës me TVSH	Likuiduar deri me 31.12. 2025
1	Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vulcan faza I njësia Adm Hotolisht B. Librazhd	Z.	1548	19.03.2025	43,004,958	11,520,000
2	Sistemim asfaltim i rrugës fshati Funares Zdrajsh faza II Njësia Administrative Orenje	C.	2083	16.04.2025	44,111,580	10,000,000
3	Sistemim asfaltim i rrugës Merqize faza I Nj. Adm Qendër Bashkia Librazhd	R.G.	5510	18.08.2025	37,069,699	3,938,327
4	Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave te artit Nj.Adm Orenje	G.	5515	18.08.2025	1,441,549	-
5	Sistemim asfaltim i rrugës Mirake -Plane ,Mirake -Katund faza e I Njësia Administrative Polis	R.G.	7168	21.10.2025	29,087,798	-
	Shuma				**154,715,584**	**25,458,327**

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Librazhd më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2025	Viti 2024	Diferenca/ndryshimi
	Llogari të pagueshme	**291,321,404**	**251,132,865**	40,188,539
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	7,367,917	31,417,211	-24,049,294
42	Detyrime ndaj personelit	22,558,381	26,604,475	-4,046,094
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	2,222,791	2,213,791	9,000
435	Sigurime shoqërore	4,650,515	5,413,706	-763,191
436	Sigurime shëndetësore	3,342,144	3,724,647	-382,503
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	73,434,683	58,464,274	14,970,409
467	Kreditorë të ndryshëm	47,024,767	6,123,679	40,901,088

Llogaria 401-408 "*Furnitor e llogari të lidhura me to*", paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara për vitin 2025 në vlerën 7,367,917 lekë, në mënyrë analitike paraqiten tabelën si vijon:

Nr.	PERSHKRIMI	NR	DATE	Vlera e pa likuiduar
1	Pajisje MZSH	155/2025	16.12.2025	294,000
2	kancelari	31/2025	26.11.2025	99,980
3	Riparime dhe mirëmbajtje sistemit te kamerave	25-Feb	17.12.2025	158,900
4	Blerje krevat për çerdhen	457/2025	16.12.2025	202,080
5	Pakot e vitit te ri	502/2025	18.12.2025	480,000
6	Kalendar dhe kartolina	240/2025	22.12.2025	100,000
7	Buke kopshte çerdhe	602/2025	31.12.2025	23,157
8	Shirita për kurora 50/2025	44/2025	30.12.2025	3,600
9	Etiketime me adeziv për pakot	51	30.12.2025	18,000
10	Suvenire për pritje delegacioni	52/2025	30.12.2025	30,000
11	Karburant Administrata	304/2025	30.12.2025	790,200
12	BLERJE FADROME	Fatura nr. 11/2025	31.10.2025	5,148,000
13	Tullumbaca me heliu	25-Feb	31.12.2025	20,000
				7,367,917

Llogaria 42, "*Detyrime ndaj personelit*", sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 22,558,381 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2025	26,604,475
Shtesa (K)	254,312,996
Pakësime (D)	258,659,090

Gjendja në 31.12.2025	22,558,381

Llogaria 431, "*Detyrime ndaj shteti për tatim taksa*", paraqitet në vlerën 2,222,791 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2025	2,213,791
Shtesa (K)	116,528,337
Pakësime (D)	116,519,337
Gjendja në 31.12.2025	2,222,791

Llogaria 435, "*Sigurime shoqërore*" dhe llogaria 436 "*Sigurime shëndetësore*" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2025, përkatësisht në vlerat 4,650,515 lekë dhe 3,342,144 lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	5,413,706
Shtesa (K)	45,977,724
Pakësime (D)	51,386,780
Gjendja në 31.12.2025	4,650,515
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Çelje e vitit 2025	3,724,647
Shtesa (K)	35,012,494
Pakësime (D)	35,394,997
Gjendja në 31.12.2025	3,342,144

Llogaria 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogaritje paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 58,464,274 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 73,434,683 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike, e cila paraqitet, në tabelën si vijon:

Njësit Administrativ	**Nr. I investimeve**	**Gjendja deri me 31.12.2023**	**Shtesat 2024**	**Pakësimet 2024**	**Gjendja 31.12.2024**	**Shtesat 2025**	**Pakësimet 2025**	**Gjendja 31.12.2025**
Bashkia Librazhd	71	44,517,634	18,235,510	7,111,626	55,641,518	21,002,136	6,031,727	70,611,927
Njësia Hotolisht		1,384,299			1,384,299	0	0	1,384,299
Njësia Polis		53,900			53,900	0	0	53,900
Njësia Qendër		665,808			665,808	0	0	665,808
Njësia Lunik		121,837			121,837	0	0	121,837
Njësia Orenj		370,412			370,412	0	0	370,412
Njësia Stebleve		226,500			226,500	0	0	226,500
Totali	**71**	**47,340,390**	**18,235,510**	**7,111,626**	**58,464,274**	**21,002,136**	**6,031,727**	**73,434,683**

Burimi: *Të dhënat nga subjekti, përpunuar nga grupi auditimit*.

Për vlerat e garancive për objektet të cilat nga bashkia janë marrë në dorëzim dhe u ka kaluar afati i garancisë duhet të bëjë njoftimin e subjekteve me qëllim likuidimin e këtyre garancive, për pasqyrimin e saktë të vlerës së llogarisë në mbyllje të vitit ushtrimorë.

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara për vitin 2025 në vlerën 47,024,767 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në tabelën si vijon:

NR	**EMERTIMI**	**PERSHKRIMI**	**NR**	**DATE**	**Vlera e pa likuiduar**
1	R.	Asfalti I rrugës Merqize Nj.Ad qendër	47/2025	13.11.2025	4,061,673
2	L.	Mbikëqyrje "Rikonstruksion tërësor dhe rindërtim I palestrës se shkollës "V.BLLOSHMI	33/2025	29.12.2025	369,425
3	2H.	Kolaudim "Asfaltim I rrugës Linik -Prevall(loti 2)	62/2025	29.12.2025	89,556
4	B.C.	Zëvendësim dhe furnizim -vendosje	42/2025	18.12.2025	343,968
5	R.	Zgjerim I parkut të qershive +Ndërtim vend-parkimeve për automjete	51/2025	23.12.2025	2,129,067
6	L.	Sistemim Asfaltim i rrugës se frashtit Vehcan faza 1	27/2025	12.06.2025	3,740,089
7	G.B.	Podium +skene	13/2025	31.12.2025	100,008

NR	EMERTIMI	PERSHKRIMI	NR	DATE	Vlera e pa likuiduar
8	H.	Permiresim I banesave 2025	44/2025	17.11.2025	18,571,880
9	E.T.	Hostimi I faqes	42/2025	31.12.2025	40,000
10	A. shpk	Ndërtimi parkut aventuresk	132/2025	30.12.2025	9,025,188
11	Z. C.	Ndërtim I shkollës Vilson Blloshmi	15/2025	29.12.2025	3,124,975
12	E.T.	Bileta avioni për jashtë	39/2025	17.12.2025	99600
13	E.T.	Blerje bileta për bagazhe	40/2025	17.12.2025	31200
14	Vendime gjyqësore				
15	Nr.521 dt. 02.03.2010	XH.GJ			139,370
		SH.D.			139,370
16	Nr.863 dt. 22.05.2024	F.H.			506,160
17	Nr.825 dt. 04.10.2016	B.H.			118,395
18	Nr.874dt 14.10.2020	R.A.			4,394,843
				Total	**47,024,767**

Analizë: Formati nr.2 "*Pasqyra e performancës financiare*" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 1,180,343,148 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Librazhd paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike ***70* "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 83,698,217 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 88,262,246 lekë, me rritje në vlerën 4,564,029 lekë.

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
70	**I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME**	**88,262,246**	**83,698,217**
700	**1. Tatimi mbi të ardhurat**	**15,940,079**	**13,910,730**
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	15,743,617	13,629,754
7001	Tatimi mbi fitimin		
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	196,462	280,976
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat		
702	**2. Tatimi mbi pasurinë**	**25,401,432**	**22,722,243**
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	25,401,432	22,382,206
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme		
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë		340,037
703	**3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**46,902,166**	**47,041,670**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	17,331,020	15,320,971
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	29,571,146	31,720,699
704	**4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare**	**0**	**0**
7040	Taksë doganore për mallrat e importit		
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarifë shërbimi doganor e kolipostë		
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
705	**5. Taksë e rrugës**		
708	**6. Të tjera tatime e taksa kombëtare**	**18,569**	**23,574**
709	**7. Gjoba e kamatë vonesa**		

Burimi i të dhënave: *Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit*

Referuar të dhënave të akt rakordimit të të ardhurave me Degën e Thesarit Librazhd datë 31.12.2025 kemi informacioni si mëposhtë:

1) Sipas kodifikimit 700 *" Tatim mbi të ardhurat"* e cila është kontabilizuar për vlerën 15,940,079 lekë janë përfshirë.

-Tatim mbi të ardhurat personale me vlerë 15,743,617 lekë;

-Tatim mbi biznesin e vogël me vlerë 196,462 lekë.

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 700 *"Tatim mbi të ardhurat"* rakordojnë sipas akt rakordimit me thesarin.

2) Sipas kodifikimit 702 *"Tatim mbi Pasuritë"* e cila është kontabilizuar për vlerën 25,401,432 lekë janë përfshirë.

a)Tatim mbi pasuritë e paluajtshme me vlerë 25,401,432 lekë;

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* sipas aktrakordimit janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Taksë mbi tokën bujqësore me vlerë 2,982,021 lekë;
-Taksa e ndërtesës me vlerë 20,400,414 lekë;
-Taksë trualli me vlerë 2,018,996 lekë;
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.
3) Sipas kodifikimit 703 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"* e cila është kontabilizuar për vlerën 46,902,166 lekë janë përfshirë.
a) Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie (7033) me vlerë 17,331,020 lekë
a)Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie (7035) me vlerë 29,571,146 lekë.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim (7033) *"Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie"* 7035 *"Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"* sipas aktrakordimit.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit (7033) *"Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie"* dhe 7035 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.
4) Sipas kodifikimit 708 *"Të tjera tatime e taksa kombëtare "* e cila është kontabilizuar për vlerën 18,569, lekë janë përfshirë.
- Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 708 "Të tjera tatime e taksa kombëtare" janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Gjendja civile pullat me vlerë 18,569 lekë;
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 708 *"Të tjera tatime e taksa kombëtare"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.

- *Të ardhurat jo tatimore***:**

Llogaria 71 "*Të ardhura jo tatimore*", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 59,093,347 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë **72,086,867 lekë** ose me rritje në vlerën 12,993,520 lekë.
Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në tabelën në vijim:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**72,086,867**	**59,093,347**
710	**1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**32,113,460**	**22,788,199**
7100	*Nga ndërmarrjet publike jo financiare*	*0*	*0*
7101	*Nga ndërmarrjet publike financiare*	*0*	*0*
7109	*Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia*	*32,113,460*	*22,488,199*
711	**2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare**	**39,973,407**	**36,605,148**
7110	*Tarifa administrative dhe rregullatorë*	*28,170,376*	*26,212,192*
7111	*Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh*	*9,826,806*	*8,665,445*
7112	*Taksë për veprime gjyqësore e noteriale*	*0*	*0*
7113	*Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve*	*138,240*	*143,500*
7114	*Të ardhura nga biletat*	*0*	*0*
7115	*Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime*	*1,837,985*	*1,584,011*
7116	*Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje*	*0*	*0*
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	**0**	0

Burimi i të dhënave: *Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit*

1) Sipas kodifikimit 7109*"Të tjera nga ndërmarrja dhe pronësia"* e cila është kontabilizuar për vlerën 32,113,460 lekë janë përfshirë.
-Të ardhura nga qira për troje me vlerë 35,218 lekë;
- Të ardhurat nga ndërmarrja dhe pronësia me vlerë 31,882,591 lekë;

-Të ardhurat nga qira për ndërtesa me vlerë 195,648 lekë.

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7109 *"Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

2) Sipas kodifikimit 7110*"Tarifa administrative dhe rregullatore"* e cila është kontabilizuar për vlerën 28,170,376 lekë janë përfshirë.

-Tarifë për akte ligjore administrative me vlerë 215,700 lekë;
-Tarifë për leje transporti me vlerë 521,400 lekë;
Tarifë pastrimi me vlerë 26,933,276 lekë;
-Tarifë repertitori me vlerë 500,000 lekë;

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7110*"Tarifa administrative dhe rregullatore",* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

3) Sipas kodifikimit 7111*"Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh"* e cila është kontabilizuar për vlerën 9,826,806 lekë janë përfshirë.

-Të ardhura nga kopshtet + tarifë regjistrimi me vlerë 6,416,290 lekë;
-Të ardhura nga çerdhet me vlerë 1,560,166 lekë;
-Tarifë parkimi me vlerë 1,850,350 lekë;

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7111*"Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

4) Sipas kodifikimit 7113*"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* e cila është kontabilizuar për vlerën 138,240 lekë janë përfshirë.

-Leje aktiviteti me vlerë 27,000 lekë;
-Të ardhura nga MNPZ me vlerë 54,600 lekë;
-Të tjera nga shitja e mallrave dhe shërbimeve me vlerë 49,640 lekë
-Miratim projekti MNZ me vlerë 7,000 lekë.

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7113*"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

Sipas kodifikimit 7115*"Gjoba kamatëvonesa sekuestrime zhdëmtime"* e cila është kontabilizuar për vlerën 1,837,985 lekë janë përfshirë.

- Kamatëvonesa me vlerë 890,128 lekë;
- Gjoba me vlerë 821,297 lekë;
- Sekuestrime dhe zhdëmtime me vlerë 126,560 lekë.

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7115*"Gjoba kamatëvonesa sekuestrime zhdëmtime"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

3. Grante kornete:

-Llogaria 72 "*Grante kornete*", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 1,056,837,557 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 1,019,994,035 lekë ose me një rritje në vlerën 36,843,522 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante kornete paraqitet në tabelën si më poshtë:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	V. GRANTE KORENTE	**1,019,994,035**	**1,056,837,557**
720	1. Grant korent i brendshëm	**1,019,994,035**	**1,056,837,557**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	429,351,944	595,342,320
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	500,422,929	436,587,154
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH		
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)		
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	149,067	139,225
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	87,166,515	6,123,179
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	2,903,580	18,645,179
7209	Të tjera grante korente të brendshme		

Burimi i të dhënave: *Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit*

Analiza e shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 1,052,749,477 lekë paraqitet më poshtë:

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 "*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*" në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 323,700,309 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 340,108,806 lekë ose me një rritje në vlerën 18,408,497 lekë.

-Llogaria 601 "*Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 53,209,106 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 55,826,972 lekë ose me një rritje në vlerën 2,617,866 lekë.

Analiza për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në tabelën si më poshtë:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
6001	Paga, personel i përhershëm	340,108,806	323,700,309
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	50,244,275	47,792,610
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	5,582,697	5,416,496

Burimi i të dhënave: ***Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit***

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 "*Blerje mallra dhe shërbime*", në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 142,864,788 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është në vlerën 98,066,235 lekë ose me ulje në vlerën 44,798,553 lekë.

Analiza e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në tabelën në vijim:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	**98,066,235**	**142,864,788**
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	2,320,570	3,624,157
6021	Materiale dhe shërbime speciale	13,297,515	17,416,364
6022	Shërbime nga të tretë	34,804,316	73,150,086
6023	Shpenzime transporti	18,834,336	20,402,949
6024	Shpenzime udhëtimi	2,269,152	3,054,246
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	0	11,500,000
6026	Shpenzime për qiramarrje	1,180,000	1,435,263
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale		
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	25,360,346	12,281,723

Burimi i të dhënave: *Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit*

3. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve 604 "*Transferime korente të brendshme* ", paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 28,910,955 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 28,490,100 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 "*Transferime për Buxhetet familjare e Individë*", paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 586,415,364 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 505,801,783 lekë. e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin, e cila paraqitet në vlerën 449,494,784 lekë.

Analiza e llogarisë transferime korente paraqitet në tabelën në vijim:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
	V. TRANSFERIME KORENTE	**534,291,883**	**615,326,319**
604	Transferime korente të brendshme	28,490,100	28,910,955
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	505,801,783	586,415,364
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH		

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore		

Burimi i të dhënave: *Bashkia Librazhd, përpunuar nga grupi auditimit*

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
63	Ndryshimi i gjendjeve të inventarit	24,455,581	(13,224,818)
	Shpenzime të tjera		

Për vitin 2025 totali i të ardhurave në vlerë është 1,180,343,148 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,052,749,477 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 127,593,671 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 "*Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor*" në vlerën 127,593,671 lekë.

- ***Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës (transaksionet financiare)***

Për verifikimin e rregullshmërisë së transaksioneve financiare të Aparatit Bashkia Librazhd, bazuar në kriteret e riskut të vlerësuara nga Grupi i auditimit është kryer kampionimi i transaksioneve mbi të cilat ishin kryer teste analitike. Në vlerësimin tonë është gjykuar që të auditohen transaksionet financiare që kanë të bëjnë me likuidimin e kontratave për punë publike (llog. 231) dhe blerje mallrash (llog. 602), si dhe likuidimet e shpenzimeve për projektet kulturore (llog.602).

Është kryer auditimi mbi rregullshmërinë e likuidimit të shpenzimeve të shpenzimet e 3 mujorit të parë 2025 për numrat nga nr. 59 deri në nr. 237, për tremujorin e fundit nga nr. 684 deri në numrin 1054), në lidhje me saktësinë e klasifikimit të shpenzimit në llogarinë e duhur, saktësinë e vlerës së likuiduar, plotësinë e dokumentacionit autorizues dhe justifikues të shpenzimit.

Nga auditimi rezultoi se bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, referuar kontratave, ndodhej i gjithë dokumentacioni ligjor bashkëshoqërues, në përputhje me kërkesat e pikave 34 dhe 35, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, dhe pikës 2.2 të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Urdhër prokurimi;
- Kontrata bazë në të cilën janë të përcaktuar vlera e kontratës, data e fillimit dhe mbarimit;
- Amendament shtesë kontrate në rastet kur është kërkuar shtesë për afat përfundimi;
- Urdhër shpenzimi për likuidimin e faturave;
- Urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim si të mallit dhe të investimeve;
- Fletë hyrjes në rastet e kontratave për blerje malli;
- Procesverbal i komisionit të marrjes në dorëzim të kontratave blerje malli;
- Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim e kontratave për investime;
- Akt-kolaudim përfundimtar në rastet e likuidimit të përfundimit të garancisë së punimeve, etj.;

Nga auditimi, rezultoi se kryerja e shpenzimeve është bërë në përputhje me Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.20218 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar.

Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik, pika 6 ku cilësohet:

"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues, të cilët dallohen në:

- *Dokumente bazë justifikues (faturë blerje/shitje, fletë-hyrje/dalje, mandat-arkëtim/ pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike, dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit.*
- *Urdhër-shpenzimi/Urdhër-pagesa që përdoren në marrëdhëniet e njësive të qeverisjes së përgjithshme me degën përkatëse të thesarit, për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e një shpenzimi apo ekzekutimin e një pagese, nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).*

- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabilitetisi dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.*
- *Dokumente të tjerë kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme".*

Si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2013 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" cilësohet:

"Pika 35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. *Dokumente autorizuese - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.*

b. *Dokumente vërtetuese - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.*

c. *Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhëse, ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj.) të çdo lloj forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.*

Pika 36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve".

Forcimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e nëpunësit autorizues, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke siguruar hartimin dhe zbatimin e planeve vjetore dhe periodike të punës, raportimin e veprimtarisë nga strukturat e administratës, zhvillimin e trajnimeve të stafit, plotësimin e dokumentacionit të personelit, ngritjen e një sistemi të dedikuar financiar-kontabël, hartimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore, miratimin e Planit Strategjik të Zhvillimit dhe forcimin e sigurisë së informacionit.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), rezultoi se Bashkia Librazhd nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, planifikimin institucional, administrimin e burimeve njerëzore dhe sistemet mbështetëse.

Vetëm nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm ishin hartuar planet vjetore/ mujore të punës dhe raportet e analizës së veprimtarisë, ndërsa drejtoritë e tjera nuk kishin hartuar. Gjithashtu, Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk kishte hartuar planin vjetor të trajnimeve dhe nuk ka zhvilluar trajnime të brendshme gjatë vitit 2025

Në dosjet e personelit u konstatuan mungesa të dokumentacionit të detyrueshëm.

Në fushën financiare u konstatua se kontabiliteti mbahet në programin Excel, në mungesë të një sistemi të dedikuar kontabël, nuk ishte hartuar dhe miratuar gjurma e auditimit, nuk ishte hartuar

Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional të Bashkisë, si dhe mungon një sistem i integruar i teknologjisë së informacionit, i shoqëruar me politika dhe procedura të miratuara për sigurinë e informacionit.
Mosfunksionimi i plotë i sistemit të MFK ka sjellë dobësim të kontrollit të brendshëm administrativ dhe financiar, mungesë të planifikimit dhe monitorimit të veprimtarisë, rritje të riskut për gabime materiale në regjistrimet kontabël, mungesë të gjurmueshmërisë së proceseve administrative dhe financiare, si dhe cenim të sigurisë së informacionit dhe efektivitetit të administrimit publik.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, neni 16; Ligjin nr. 68/2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", neni 32; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*", Kreu II, Lidhja 2, pika 3, VKM nr. 124, datë 17.02.2016, i ndryshuar, Kreu III, pika 23, paragrafi 2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 13-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë dhe drejtuesve të njësive organizative, të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e plotë të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke siguruar:
- hartimin dhe miratimin e planeve vjetore, mujore dhe raporteve periodike të analizës së veprimtarisë për çdo drejtori;
- hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të trajnimeve të stafit, si dhe plotësimin e dokumentacionit të dosjeve të personelit;
- hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore administrative dhe financiare;
- hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional të Bashkisë;
- implementimin e një sistemi të dedikuar kontabël dhe eliminimin e përdorimit të Excel-it, si sistem bazë i regjistrimit kontabël;

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, u konstatua se nuk janë përmbushur plotësisht kërkesat e kuadrit ligjor dhe standardeve profesionale në fuqi. Konkretisht:
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, megjithëse subjekti plotëson kriteret ligjore për krijimin e tij.
- Asnjë prej punonjësve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk zotëron certifikatën profesionale "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik". Megjithëse procesi i certifikimit ka qenë i pezulluar për një periudhë trevjeçare, pas rihapjes së tij në vitin 2026, nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se punonjësit nuk kanë ndërmarrë veprime për t'u regjistruar dhe për të ndjekur procesin e certifikimit profesional. Kjo situatë evidenton mungesën e masave të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të kualifikimit profesional të audituesve të brendshëm. Mosngritja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe mosmarrja e masave për certifikimin profesional të punonjësve krijojnë risk për funksionimin efektiv të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, respektimin e kërkesave ligjore dhe sigurimin e cilësisë së shërbimit të auditimit.
Gjithashtu, në Planin Strategjik dhe Planin Vjetor të Auditimit nuk janë përfshirë për auditim disa fusha me risk të lartë, konkretisht: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimet Mbështetëse, përfshirn sektorin e prokurimeve publike, Drejtoria e Planifikim, Zhvillim Kontroll Territorit, duke mos siguruar mbulim të plotë të aktiviteteve me ekspozim të lartë ndaj riskut.
Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk kishte hartuar dhe zbatuar Programin e Sigurimit dhe Përmirësimit të Cilësisë, në kundërshtim me standardet profesionale të auditimit të brendshëm.

Këto mangësi tregojnë se funksioni i auditimit të brendshëm nuk është organizuar dhe administruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale, duke kufizuar aftësinë e tij për të ofruar siguri dhe këshillim mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe qeverisjes.
Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", për nenet 12 dhe 14; VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", pika 3; Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1 dhe 3.2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2 faqe 17-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me drejtuesin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, të marrë masat e nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi; sigurimin e ushtrimit të funksionit të auditimit të brendshëm nga audituesë të certifikuar, nëpërmjet regjistrimit dhe ndjekjes së procesit të certifikimit profesional të punonjësve të pacertifikuar, duke përcaktuar afate dhe përgjegjësi të qarta; garantimin e hartimit të planeve strategjike dhe vjetore të auditimit mbi bazën e vlerësimit të riskut, duke përfshirë auditimin periodik të të gjitha fushave me risk të lartë, veçanërisht prokurimet publike dhe lejet e ndërtimit dhe zhvillimit; si dhe hartimin dhe zbatimin e Programit të Sigurimit dhe Përmirësimit të Cilësisë, duke siguruar kryerjen e vlerësimeve periodike të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim forcimin e efektivitetit, pavarësisë dhe cilësisë së funksionit të auditimit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e të ardhurave vendore, akt-rakordimeve me Degën e Thesarit dhe evidencave të Drejtorisë së të Ardhurave për vitin 2025, rezultoi se të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë realizuar në masën 76%, ku nga plani prej 214,268 mijë lekë janë arkëtuar 163,800 mijë lekë, duke mbetur të parealizuara vlera prej 50,468 mijë lekë.
Analiza sipas kategorive të të ardhurave evidentoi se të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar në masën 68%, të ardhurat nga tarifat vendore në masën 92%, të ardhurat nga sektori i pyjeve dhe kullotave në masën 72% dhe të ardhurat e tjera në masën 67%.
Gjithashtu, rezultoi se plani i të ardhurave për vitin 2025 është rritur me 38,762 mijë lekë krahasuar me vitin 2024, pa u mbështetur në një analizë të plotë të bazës tatimore, kapaciteteve reale të arkëtimit, ecurisë historike të realizimit dhe rezervave të identifikuara të të ardhurave.
Në veçanti, për Taksën e Ndikimin në Infrastrukturë (TNI), plani është rritur nga 10,302 mijë lekë në vitin 2024 në 20,000 mijë lekë në vitin 2025 (rritje prej 9,698 mijë lekë ose rreth 94%), ndërkohë që realizimi faktik ishte vetëm 28% e planit, ç'ka tregon se planifikimi nuk është mbështetur mbi tregues objektivë dhe të verifikueshëm.
Si rezultat i planifikimit jo realist dhe mosrealizimit të të ardhurave në vlerën 50,468 mijë lekë, Bashkia ka krijuar mungesë të burimeve financiare për financimin e shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara në buxhet, duke ndikuar negativisht në realizimin e projekteve për përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës në funksion të komunitetit.
Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshkur, neni 64, neni 65; Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" për nenet 4,16,22; Ligjin nr. 9936/2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 4.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 29-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë së të Ardhurave, të marrë masa që planifikimi i të ardhurave vendore të hartohet mbi bazën e analizave të dokumentuara të potencialit fiskal, ecurisë historike të arkëtimeve, bazës së tatimpaguesve dhe faktorëve ekonomikë që ndikojnë në realizimin e tyre. Për çdo zë të rëndësishëm të të

ardhurave të përgatiten analiza mbështetëse që justifikojnë nivelin e planifikimit, duke shmangur mbivlerësimin e të ardhurave.
Të forcohen mekanizmat e monitorimit periodik të realizimit të të ardhurave dhe, kur evidentohen devijime të konsiderueshme nga plani, të propozohet rishikimi i buxhetit sipas procedurave ligjore, dhe të hartohet një plan masash konkrete për rritjen e nivelit të arkëtimit të detyrimeve vendore dhe shfrytëzimin e plotë të rezervave fiskale.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të të ardhurave vendore që arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se bashkia nuk ka ngritur dhe administruar një bazë të plotë, të saktë dhe të përditësuar të të dhënave mbi subjektet tatimpaguese dhe detyrimet përkatëse. Konkretisht, mungon informacioni i konsoliduar mbi numrin e subjekteve tatimpaguese sipas kategorive; llojin e detyrimeve tatimore që arkëtohen nga agjentët tatimorë; periudhën e ushtrimit të aktivitetit; detyrimet e likuiduara dhe detyrimet e papaguara; vlerën e detyrimeve të arkëtuara nga agjentët tatimorë, por ende të paderdhura në llogaritë e bashkisë dhe subjektet që përfitojnë përjashtime ose lehtësime fiskale.
Gjithashtu, nga verifikimi i marrëdhënieve me agjentët tatimorë dhe i rakordimeve periodike rezultoi se procesi i rakordimit nuk kryhet në mënyrë të plotë dhe efektive, duke mos siguruar verifikimin e saktësisë së të ardhurave të arkëtuara dhe të transferuara në buxhetin e bashkisë.
Si pasojë, niveli i realizimit të planit të të ardhurave rezultoi dukshëm i ulët për disa zëra, konkretisht:
Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë, me rreth 12%; Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin (i administruar nga Drejtoria Rajonale Tatimore), me rreth 46%.
Kjo situatë tregon se planifikimi i këtyre të ardhurave nuk është mbështetur në të dhëna reale dhe të verifikueshme të siguruara nga agjentët tatimorë, si dhe mungesa e rakordime mujore dhe vjetore të plota me institucionet përgjegjëse për administrimin e këtyre të ardhurave, duke përfshirë administratën tatimore dhe institucionin përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", nenet 54 dhe 64; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; Ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, për nenet 16 dhe 19; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 7 dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 15, si dhe me Udhëzimin e MF nr. 26, datë 04.09.2008 "*Për taksat Kombëtare*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 29-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave dhe Drejtorisë së Financës të marrë masa si vijon:
- të krijojë dhe administrojë një bazë të integruar të të dhënave për të gjitha detyrimet vendore që arkëtohen nga agjentët tatimorë, duke evidentuar subjektet tatimpaguese, detyrimet sipas llojit, periudhën tatimore, pagesat, detyrimet e papaguara, përjashtimet dhe detyrimet e arkëtuara por të paderdhura;
- të sigurojë marrjen sistematike të informacionit nga agjentët tatimorë dhe të kryejë rakordime mujore e vjetore të dokumentuara për të gjitha të ardhurat që arkëtohen në emër të bashkisë;
- të mbështesë planifikimin e të ardhurave në analiza reale dhe në të dhënat e rakorduara me institucionet përgjegjëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027 dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2025, rezultoi se planifikimi i treguesve buxhetorë nuk është bazuar në analiza

reale të kapacitetit financiar të Bashkisë Librazhd dhe nivelit historik të realizimit të të ardhurave, duke sjellë devijime të konsiderueshme midis planifikimit dhe realizimit të buxhetit.
Nga fondi i përgjithshëm në vlerën prej 1,776,797 mijë lekë të planifikuar, është realizuar vlera 1,570,315 mijë lekë ose 88%, ndërsa kanë mbetur të parealizuara vlera prej 206,482 mijë lekë. Realizimi i treguesve sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve ka variuar nga 61% deri në 98%, çka tregon se planifikimi nuk është mbështetur në parashikime reale të burimeve financiare.
Në zërin e investimeve, nga fondi i planifikuar në vlerën prej 537,496 mijë lekë është realizuar vlera prej 427,388 mijë lekë ose 80%, duke mbetur të parealizuara vlera prej 110,108 mijë lekë. Planifikimi i investimeve është bazuar në të ardhurat e programuara dhe jo në kapacitetin real të arkëtimit, ndërkohë që realizimi i të ardhurave në vite rezultoi në nivelet 70–80%.
Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e investimeve është planifikuar me financim dhe likuidim 2–3 vjeçar, megjithëse kontratat kanë afate zbatimi brenda një viti buxhetor (2–5 muaj). Auditimi nuk evidentoi analiza financiare ose tekniko-ekonomike që të justifikonin shtrirjen shumëvjeçare të pagesave. Si pasojë, një pjesë e konsiderueshme e vlerës së kontratave është shtyrë për t'u likuiduar në vitet pasardhëse, duke rritur detyrimet financiare të bashkisë dhe duke kufizuar hapësirat fiskale të buxheteve të ardhshme.
Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenet 4,45 dhe 54; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 9 pika 1.3 germa "c" dhe "ç"; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", nenet 2 dhe 3 pika 3 dhe nenet 34,40 dhe 54; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; Udhëzimin e MF nr. 2 datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit*" i ndryshuar, pikat 253 dhe 354 dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 19-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëveprim me Drejtorinë Ekonomike dhe Buxhetit Bashkia Librazhd, të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor, duke u bazuar në analizën e realizimit faktik të të ardhurave dhe shpenzimeve të viteve të mëparshme dhe në kapacitetin real të arkëtimit.
Planifikimi i investimeve të bëhet në përputhje me burimet e sigurta të financimit dhe mundësitë reale të likuidimit, duke shmangur mbivlerësimin e të ardhurave dhe planifikimin e detyrimeve për periudha të ardhshme pa analiza financiare dhe tekniko-ekonomike.
Për investimet e planifikuara të sigurohet përputhja ndërmjet afateve të zbatimit të kontratave, planit të financimit dhe likuidimit, me qëllim realizimin në kohë të investimeve dhe kufizimin e krijimit të detyrimeve financiare për buxhetet pasardhëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se 3 fatura, me vlerë të mbetur për t'u likuiduar prej 12,949 mijë lekë, nuk janë shlyer në vlerën e tyre të plotë, pasi janë kryer vetëm pagesa pjesore. Moslikuidimi i plotë i këtyre detyrimeve ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve, të shkaktuar nga niveli i pamjaftueshëm i realizimit të të ardhurave vendore, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*", i ndryshuar, pika 151.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 19-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa për evidentimin, verifikimin dhe rakordimin e detyrimeve të mbetura për 3 faturat, në vlerën totale prej 12,949 mijë lekësh, si dhe të sigurojë likuidimin e plotë të tyre, në përputhje

me mundësitë e likuiditetit dhe fondet e disponueshme, duke respektuar radhën e shlyerjes së detyrimeve dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin dhe zbatimin e buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa për forcimin e planifikimit dhe monitorimit periodik të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, duke siguruar që marrja e angazhimeve financiare dhe krijimi i detyrimeve të reja të bëhen në përputhje me fondet e disponueshme dhe realizimin faktik të të ardhurave. Gjithashtu, të sigurohet ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së realizimit të buxhetit dhe përshtatja në kohë e angazhimeve financiare me mundësitë reale të financimit, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe shmangien e kryerjes së pagesave të pjesshme për shkak të mungesës së fondeve**.**

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procesi i inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve/ shtesat/ pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në pasqyrën nr. 7/a, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)", pasqyrën nr. 7/b, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-daljet nga magazina etj.
Nga ana e komisioneve është bërë inventarizimi i llogarive *32* "Inventar i imët", llogarinë 214 " Instalime teknike Makineri pajisje" dhe llogarinë 218 "Inventar ekonomik", ndërsa për llogaritë e tjera të Aktiveve Afatgjata Materiale nuk është kryer inventarizimi fizik, si rrjedhojë pasqyrat financiare përmbajnë vetëm vlerat kontabël të tyre, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket llogarive në fund të vitit.
Gjithashtu, nga auditimi i procedurës së inventarizimit të aktiveve, u konstatua se:
- Komisioni i inventarizimit fizik nuk kishte hartuar relacionin përmbledhës mbi procedurën e inventarizimit fizik, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar, Kreu IV, pika 85/c.
- Nuk ka krijuar një regjistër aktivesh sipas kërkesave ligjore, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar, Kreu III, pika 26,27,28,29,30 dhe 31;
- Lista e aktiveve të vlerësuara të dëmtuara nuk përmban informacion të plotë si vitin e hyrjes së aktivit, koha e përdorimit, shpenzimet për mirëmbajtje etj., në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar, kreu III pika 30, kreu IV pika 85/b dhe 95.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit, të marrin masa për kryerjen e plotë dhe periodike të procesit të inventarizimit të të gjitha aktiveve të njësisë, përfshirë aktivet e evidentuara në llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "*Pyje, plantacione*", 212 "*Ndërtesa e konstruksione*" dhe 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", duke realizuar verifikimin fizik në terren dhe dokumentimin e plotë të rezultateve të inventarizimit.
Gjithashtu, të sigurohet zbatimi i procedurave standarde të inventarizimit, plotësimi dhe miratimi i dokumentacionit përkatës raportues, si dhe identifikimi dhe administrimi i risqeve që lidhen me ruajtjen, përdorimin dhe administrimin e aktiveve, me përcaktimin e masave konkrete për minimizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2025, u konstatua se llogaria 202 "*Studime dhe projektime*" në formatin Nr. 7/a paraqitet me koston historike në vlerën 46,341,008 lekë, e analizuar për 46 objekte inventari. Nga verifikimi i inventarit kontabël rezultoi se 34 projekte me vlerë 32,361,069 lekë, të cilat i përkasin periudhave të hershme (2011 -2023), nuk ka informacion nëse janë vënë në zbatim për tu sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e AAM, të numrit të tyre për efekt të inventarizimit fizik dhe llogaritjes së amortizimit, veprim në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit, të marrë masa për kryerjen e një verifikimi të plotë të 34 projekteve të evidentuara në llogarinë 202 "*Studime dhe projektime*", me vlerë 32,361,069 lekë, për të përcaktuar statusin e secilit projekt (nëse është zbatuar, në proces ose i pazbatuar). Për projektet e zbatuara të kryhen sistemimet kontabël për transferimin e vlerës së tyre në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale si pjesë e kostos së investimit të përfunduar, ndërsa për projektet që nuk do të zbatohen të merren vendimet administrative dhe kontabël sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim që pasqyrat financiare të paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të besueshme gjendjen e aktiveve afatgjata materiale.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatus se sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" në mbyllje të vitit 2025, llogaria 212 "*Ndërtime konstruksione*" paraqitet në vlerën 1,127,763,497 lekë. Referuar inventarit kontabël rezultoi se për 36 objekte me vlerë të mbetur 270,428,882 lekë, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM-së, por janë trajtuar si aktive më vete. Gjithashtu nuk jep informacion se sa nga asetet e transferuara me VKM me listë përfundimtarë janë të regjistruara në kontabilitet.

Amortizimi nuk është llogaritur për çdo artikull por në grup, në këtë llogari ka vlera të paanalizuara me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerat neto dhe inventarin fizik, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar, Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", germa b).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit, Bashkia Librazhd të marrë masa për:

- Evidentimin dhe analizimin e plotë të llogarisë 212 "*Ndërtime, konstruksione*", duke krijuar kartelë analitike për çdo aktiv afatgjatë material, ku të pasqyrohet kostoja fillestare, investimet e mëpasshme, amortizimi i akumuluar dhe vlera neto kontabël.
- Rishikimin e trajtimit kontabël të rikonstruksioneve, mbikëqyrjes, kolaudimit dhe investimeve të tjera që plotësojnë kriteret e kapitalizimit, duke i shtuar ato kostos së aktivit përkatës dhe jo duke i evidentuar si aktive më vete.
- Identifikimin dhe rakordimin e aktiveve të transferuara me VKM, duke siguruar që të gjitha asetet e transferuara me listë përfundimtare të jenë të regjistruara në kontabilitet dhe të dokumentohen diferencat e konstatuara.

- Llogaritjen e amortizimit për çdo aktiv individual dhe jo në nivel grupi, në mënyrë që pasqyrat financiare të paraqesin saktë vlerën neto të aktiveve dhe të mundësohet rakordimi me inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit kontabël dhe i të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Bashkisë Librazhd, u konstatua se disa aktive afatgjata materiale vijojnë të evidentohen me vlera historike relativisht të ulëta, pa u dokumentuar kryerja e procedurave të nevojshme për verifikimin dhe analizimin e saktësisë së vlerave të tyre kontabël. Konkretisht, referuar inventarëve kontabël, në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" rezultojnë 7 objekte me vlera që variojnë nga 5,101 lekë deri në 92,292 lekë (tabela nr. 1), ndërsa në llogarinë 215 "Mjete transporti" rezultojnë 6 mjete me vlera që variojnë nga 5,676 lekë deri në 91,572 lekë (tabela nr. 2). Këto vlera janë evidentuar mbi bazën e kostove historike të blerjes apo krijimit të aktiveve, pa u dokumentuar një analizë e mjaftueshme për të verifikuar nëse ato pasqyrojnë saktë gjendjen dhe vlerën kontabël të aktiveve, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të zbatueshëm për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Mungesa e dokumentacionit përkatës dhe e procedurave të verifikimit krijon riskun e paraqitjes jo të saktë të vlerës së aktiveve në pasqyrat financiare.
Në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", kreu IV, pika 73, pika 74, pika 81, si dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme*", konkretisht Pasqyra Statistikore nr. 2/1 "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)" dhe Pasqyra Statistikore nr. 2/2 "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Vlera neto)", në të cilat pasqyrohen edhe aktivet e llogarive 212 "Ndërtime e konstruksione" dhe 215 "Mjete transporti".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëveprim me Drejtorinë Ekonomike dhe Buxhetit, të marrë masa, për ngritjen e grupeve të punës për rivlerësimin e aktiveve të klasifikuara në llogarinë 212 "*Ndërtesa dhe konstruksione*" dhe llogarinë 215 "*Mjete transporti*", si dhe sistemimin e veprimeve kontabël pas rivlerësimit të tyre.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2025, rezultoi se llogaria 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"* në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 687,363,916 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël rezultoi se, nuk është zbritur vlera për 8 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në shumën 78,700,102 lekë që duheshin transferuar UK Elbasan (sipas tabelës faqe 45 e RPA), me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 24 dhe 30.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit Bashkia Librazhd, të marrë masa për transferimin në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" Sh.A të 8 artikujve kontabël pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 78,700,102 lekë.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi*:* Nga rakordimi i vlerave të çeljes së aktiveve afatgjata materiale, të paraqitura në Aneksin nr. 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", me analizat e inventarit kontabël, u konstatuan diferenca për llogaritë 210, 212, 213, 214 dhe 215 në shumën e përgjithshme 3,172,193,455 lekë. Diferencat sipas llogarive janë: 6,672,919 lekë për llogarinë 210; 17,388,419 lekë për llogarinë 212; 3,084,502,289 lekë për llogarinë 213; 4,732,171 lekë për llogarinë 214; dhe 58,896,657 lekë për llogarinë 215.
Nga krahasimi paraprak rezultoi se për disa prej llogarive diferencat përkojnë me pakësime ose transferime të raportuara gjatë vitit 2025, të cilat në analizat e inventarit janë reflektuar në vlerën e çeljes, në vend që të paraqiteshin si lëvizje të periudhës. Për llogarinë 213 u konstatuan gjithashtu diferenca në klasifikimin e shtesave dhe pakësimeve, ndërsa për llogarinë 214 analiza e inventarit nuk rakordon aritmetikisht me vlerën përfundimtare të raportuar.
Për diferencat e mësipërme, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk u evidentua një rakordim i plotë ndërmjet çeljes, shtesave, pakësimeve/transferimeve dhe gjendjes përfundimtare, si dhe nuk u provua nëse ndryshimet burojnë nga zbatimi i rekomandimeve të auditimeve të mëparshme dhe nëse janë mbështetur me dokumentacion justifikues e shpjeguar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Kjo situatë krijon pasiguri mbi saktësinë dhe klasifikimin kohor të lëvizjeve të aktiveve të raportuara në Aneksin nr. 7/a dhe nuk siguron gjurmë të plotë auditimi për ndryshimet e kryera, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, konkretisht me pikën 5, shkronja "g".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit, Bashkia Librazhd, të kryejë rakordimin e plotë dhe të dokumentuar të vlerave të llogarive 210, 212, 213, 214 dhe 215, ndërmjet inventarit kontabël, regjistrit të aktiveve dhe Aneksit nr. 7/a; të identifikojë dhe dokumentojë shkaqet e diferencave në shumën 3,172,193,455 lekë; të verifikojë nëse ato lidhen me transferime, pakësime ose zbatimin e rekomandimeve të mëparshme; dhe, sipas rezultateve, të kryejë korrigjimet përkatëse në evidencat dhe pasqyrat financiare, duke i shpjeguar ato në shënimet shpjeguese.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" paraqitet më 31.12.2025 me gjendje 0 lekë. Ndërkohë, nga testimi i kontratave u identifikuan objekte investimi të papërfunduara, për të cilat deri më 31.12.2025 janë likuiduar gjithsej 70,551,606 lekë, *nga të cilat 45,093,279 lekë për objekte që lidhen me llogarinë përfundimtare 212 dhe 25,458,327 lekë për objekte që lidhen me llogarinë përfundimtare 213*.
Nga verifikimi i regjistrimeve kontabël rezultoi se këto shuma janë debituar drejtpërdrejt në llogaritë 212 dhe 213, megjithëse objektet nuk kishin përfunduar dhe nuk ishin marrë përfundimisht në dorëzim/vënë në përdorim. Regjistrimi duhej të kryhej në debi të llogarisë 231 dhe vetëm pas përfundimit e marrjes në dorëzim kostoja duhej të transferohej në debi të llogarisë 212 ose 213 dhe në kredi të llogarisë 231.
Për pasojë, më 31.12.2025 llogaria 231 është nënvlerësuar me 70,551,606 lekë, ndërsa llogaritë 212 dhe 213 janë mbivlerësuar përkatësisht me 45,093,279 lekë dhe 25,458,327 lekë. Ky është gabim klasifikimi brenda aktiveve afatgjata materiale; ndikimi në totalin e aktiveve është zero, për aq sa shumat janë regjistruar tërësisht në llogaritë 212/213, veprime në kundërshtim Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23, sipas tabelës 3 dhe 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit, Bashkia Librazhd të marrë masa për analizimin dhe sistemimin e regjistrimeve kontabël të investimeve të papërfunduara, objekt për objekt, mbështetur në kontratat, faturat, situacionet e punimeve dhe aktet e marrjes në dorëzim.
Për objektet e papërfunduara më 31.12.2025, vlera prej 70,551,606 lekësh, e regjistruar në llogaritë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore", të riklasifikohet në llogarinë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT", nëpërmjet regjistrimeve korrigjuese: debi llogaria 231 / Kredi llogaria 212, për 45,093,279 lekë, dhe debi llogaria 231 / Kredi llogaria 213, për 25,458,327 lekë.
Pas përfundimit të punimeve, marrjes përfundimtare në dorëzim dhe vënies së aktiveve në përdorim, kostot e akumuluara në llogarinë 231 të transferohen në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale, nëpërmjet debitimit të llogarisë 212 ose 213 dhe kreditimit të llogarisë 231.
Gjithashtu, të verifikohet nëse për këto objekte është përllogaritur amortizim gjatë periudhës kur ato kanë qenë ende të papërfunduara dhe, nëse po, të kryhen korrigjimet përkatëse.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore rezultoi se, deri më 31.12.2024, Bashkia Librazhd kishte detyrime në vlerën 12,084,603 lekë. Gjatë vitit 2025, këto detyrime janë shtuar me vlerën 824,555 lekë, ndërsa janë likuiduar 7,611,020 lekë, duke rezultuar me një detyrim të mbetur për likuidim më 31.12.2025 në vlerën 5,298,138 lekë, që u përket vendimeve gjyqësore për largimin nga puna të 3 punonjësve**.**
Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se Kryetari i Bashkisë nuk kishte kryer analizë të dokumentuar të shkaqeve që kanë sjellë humbjen e proceseve gjyqësore dhe nuk kishte urdhëruar evidentimin e përgjegjësive administrative të personave të përfshirë në procedurat e largimit nga puna, me qëllim përcaktimin e përgjegjësive, sipas rastit, dhe marrjen e masave për parandalimin e rasteve të ngjashme. Gjithashtu, nuk rezultoi të ishin përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e procedurave të administrimit të marrëdhënieve të punës, forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e risqeve që lidhen me vendimmarrjet administrative, të cilat mund të sjellin detyrime financiare për bashkinë.
Sa më sipër, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, konkretisht: Nenit 2, Nenit 5, pikat 1 dhe 2, Nenit 8, pika 1, Nenit 19, Nenit 20, pika 1 dhe pika 2, shkronjat "b", "c" dhe "ç", Nenit 21, pika 1, si dhe Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 64.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 19–29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për kryerjen e një analize të plotë dhe të dokumentuar të vendimeve gjyqësore të humbura për largimet nga puna, duke evidentuar shkaqet, mangësitë procedurale dhe përgjegjësitë administrative të personave të përfshirë, sipas rastit, si dhe të përcaktojë masa konkrete për përmirësimin e procedurave të administrimit të marrëdhënieve të punës dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, me qëllim parandalimin e rasteve të ngjashme dhe shmangien e kostove të panevojshme për buxhetin e bashkisë.

Menjëherë

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE (TË ARDHURAT E MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve rezultoi se, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore edhe pse ka zbatuar pjesërisht përcaktimet

e Kreut XI të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, përsëri u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2025, gjendja e debitorëve është e lartë me vlerë 110,873,273 lekë kjo për 5287 subjekte, ose gati 50% e planifikimit vjetorë të të ardhurave, *nga e cila:*
- për subjektet fizik/juridik në vlerën 62,247,869 lekë (*nga kjo debitorë të vitit 2025 janë për vlerën 15,024,070 lekë*);
- abonentë familjarë për vlerën 48,625,404 lekë (*nga kjo debitorë të vitit 2025 për vlerën 7,908,321 lekë*).

Pra, debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për vlerën 110,873,273 lekë, ku vlera prej 22,932,391 lekë janë debitorë të vitit 2025 të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 29-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të Bashkisë Librazhd, të marrë masa për evidentimin dhe rakordimin e plotë të detyrimeve të prapambetura në vlerën 110,873,273 lekë, nga të cilat 22,932,391 lekë i përkasin aktivitetit të vitit 2025.
Për çdo kategori debitori të hartohen dhe zbatohen plane konkrete veprimi, ku të përcaktohen debitorët, vlera dhe periudha e krijimit të detyrimit, masat që do të ndërmerren, strukturat dhe personat përgjegjës, si dhe afatet e realizimit. Për arkëtimin e detyrimeve të përdoren, sipas rastit, të gjitha procedurat administrative dhe ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë njoftimin, kërkesën për pagesë dhe procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit.

Brenda 6 muajve dhe në vijimësi

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të krijojë dhe zbatojë një sistem të dokumentuar për monitorimin periodik të debitorëve dhe të masave të ndërmarra për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura. Në mënyrë periodike të analizohen niveli i arkëtimeve, ndryshimi i gjendjes së debisë, vjetërsia e detyrimeve dhe efektiviteti i masave të zbatuara.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet informale (ndërtimet e reja), rezultoi se gjendja progresive më 31.12.2024 është për vlerën 8,377,000 lekë, shtuar gjatë vitit 2025 vlera 4,429,000 lekë, paguar gjatë vitit 2025 vlera 3,873,000 lekë dhe gjendja progresive më 31.12.2025 e paarkëtuar është **8,933,000 lekë për 200 praktika**, në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*", pika 5; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave vendore*", i ndryshuar, neni 27, pika 3/c.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 29-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëveprim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitorë për Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin vlerës **8,933,000 lekë**, sipas listës që administron Drejtoria e Planifikim Zhvillim, kontroll Territorit bashkia Librazhd.

Brenda datës 31.12.2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga kontratat e qirasë rezultoi se, në territorin e Bashkisë Librazhd, janë lidhur 90 kontrata qiraje për veprimtari të ndryshme, me afate nga 1 deri në 10 vjet, me detyrim vjetor në vlerën 17,833,927 lekë. Në fund të vitit 2024 rezultonin detyrime të prapambetura në vlerën 4,438,493 lekë. Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar gjithsej 17,921,455 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 rezultoi ende për t'u arkëtuar vlera 4,350,965 lekë. Kjo situatë tregon se administrimi dhe ndjekja e detyrimeve të qiramarrësve

nuk ka siguruar arkëtimin në kohë të të ardhurave të Bashkisë nga kontratat e qirasë, në kundërshtim me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi, përfshirë nenet 826–840 të Kodit Civil dhe nenin 36 të ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 29-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit**).***

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëveprim me Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave dhe Drejtorinë e Financës të marrin masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **4,350,965 lekë nga 18 subjekte** qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për qiranë nga fondi pyjor/kullosor marrë me qira (*sipas aneksit 2.2.5.2 në RPA*). Në çdo rast të mospagesës së detyrimeve kontraktore të kërkojë prishjen e kontratës ose të mos nënshkruajë kontratën e re për objektet/tokën e lëshuar me qira, si dhe të llogarisë penalitetet, sipas rastit.

Brenda datës 31.12.2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të papaguara rezultoi se, më 31.12.2025, Bashkia Librazhd kishte detyrime të palikuiduara në vlerën 5,298,138 lekë, që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për largimin nga puna të 3 punonjësve. Këto detyrime, megjithëse të njohura në kontabilitet, nuk ishin shlyer deri në fund të periudhës objekt auditimi. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit buxhetor u konstatua se nuk ishin planifikuar fonde të mjaftueshme për shlyerjen e tyre, si dhe nuk rezultoi të ishte hartuar një plan konkret për likuidimin e detyrimeve, me përcaktimin e afateve dhe burimeve të financimit.

Mosplanifikimi i fondeve të nevojshme dhe mungesa e një plani konkret shlyerjeje krijojnë risk për shtimin e kostove financiare, përfshirë shpenzimet e mundshme të ekzekutimit të detyrueshëm, si dhe për rëndimin e buxhetit të bashkisë në periudhat pasardhëse.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 142, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore; me pikat 3, 5 dhe 9 të Udhëzimit të Kryeministrit nr. 1, datë 04.06.2014, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", që përcaktojnë planifikimin e fondeve buxhetore, respektimin e radhës së ekzekutimit, hartimin dhe publikimin e grafikut të shlyerjes, si dhe pasojat e mosndjekjes së procedurave të ekzekutimit vullnetar; me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për disiplinën dhe menaxhimin e fondeve buxhetore; si dhe me nenet 8, 9 dhe 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, lidhur me përgjegjshmërinë menaxheriale dhe detyrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 19-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Librazhd, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa për planifikimin e fondeve të nevojshme në buxhet dhe hartimin e një plani konkret për shlyerjen e detyrimeve të papaguara që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, në vlerën 5,298,138 lekë, duke përcaktuar afatet dhe burimet e financimit, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore, shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e kostove shtesë për buxhetin e bashkisë.

Brenda datës 30.06.2027

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, shkronja "c", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore" të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Librazhd** që, për shkeljet dhe përgjegjësitë e evidentuara në Raportin

Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të institucionit të shqyrtojë rastet e punonjësve përgjegjës dhe, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, të vlerësojë fillimin e procedurave disiplinore.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT